REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
Nr.No.Br. 052-18749/25
Data-Date-Datum 20.06.2025

# RAPORTI MBI PROCESIN E TAKIMEVE DHE DISKUTIMEVE PËR DRAFT PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË KLINËS

**2025 - 2033**

Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Klinës është hartuar nga Komuna e Klinës.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

**Komuna e Klinës**
**Kryetari i Komunës**
**01Nr.020-15908/2025**
**Klinë, datë 29/05/2025**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt.04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 11,12 dhe 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr.04/L-174, dispozitat e nenit 12 te U.A të MMPH-së, nr.05/2014, dispozitat e U.A të MMPH-së nr.11/2015, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, më propozimin e Drejtorit të DUMM, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

# VENDIM

Për formimin e komisionit për hartimin e Raportit të shqyrtimit publik
të Draft Planit Zhvillimor Komunal PZHK 2025-2033

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për shqyrtimin e komenteve dhe hartimin e Raportit të Shqyrtimit Publik lidhur më dokumentin e planifikimit- Draft Planin Zhvillimor të komunës së Klinës (PZHK)2025-2033

   Përbërja e komisionit do të jete si në vijim:
   **1.1. Klementina Qerkinaj kryesues/e,**
   **1.2. Altin Mujaj anëtar,**
   **1.3. Adem Sejdiu anëtar,**
   **1.4. Xhezide Trepça Gashi anëtare,**
   **1.5. Antonia Selmani anëtarë,**

2. Komisioni mbledh, analizon komentet, propozimet e vërejtjet e marra gjate fazës së shqyrtimit publik dhe arsyeton miratimin apo refuzimin e tyre, si dhe harton Raportin e Shqyrtimit Publik brenda afateve te parapara.

3. Komisioni punën e vet e kryen ne baze të dispozitave të U.A të MMPH-së, nr.05/2014 për përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinorë, si dhe aktet tjera ligjore e nënligjorë në fuqi qe rregullojnë këtë fushë.

4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

<u>Te njoftohen:</u>
- Te përmendurit;
- Drejtoria e Urbanizmi;
- Kompania konsulentë;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

**Kryetari,**
Zenun Elezaj

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

*Kuvendi i Komunës Klinë*
*01Nr.06-8440 /2025*
*Datë: 26.03 /2025*

***Ne baze te nenit 12, nenit 17 shkronja (b), te Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, te Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës" dt. 28 qershor 2008), nenit 5 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2.1, nenit 11 paragrafi 1, nen paragrafi 1.12 dhe nenin 15 dhe 20 te Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, ("Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosovës" dt. 23.08.2013), Udhëzimit Administrativ te MMPH Nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve te Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut ne Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2015 mbi elementet kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit zhvillimor komunal, Nenin 10 pikën 4) të Statutit të Komunës së Klinës si dhe me pëlqimin e dhen nga MMPHI me nr. SP-O2-8601-2 i datës 14.02.2025, me kërkesën për rishqyrtim nga MMPHI me nr.prot. 1229/25, me kërkesën e DUMM-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e III-të të rregullt për vitin 2025 të mbajtur me 21.03.2025, mori këtë:***

**VENDIM**

***Për rishqyrtimin e vendimit 01Nr.06-6125/2025 për shqyrtimin publik të projektit "Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033"***

**Neni 1**

Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033" sipas shkresës së MMPHI-së me ***nr.prot. 1229/25.***

**Neni 2**

Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i projekt "Plani Zhvillimor Komunal i Klinës-PZHK 2025-2033", bëhet në sallën e Kuvendit te Komunës 8(tete), dite pas hyrjes ne fuqi të këtij Vendimi .

**2.1** Ekspozimi i projekt " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033", behet ne sallën e Kuvendit të Komunës.

**2.2** Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën mbahen prezantime shtese sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjate kohës se shqyrtimit publik.
**2.3** Për të gjitha prezantimet e organizuara publike mbahet procesverbali.
**2.4** Shqyrtimi publik i Project " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033"", zgjatë 30(tridhjetë) dite sipas procedurave të përcaktuara me ligj.
**2.5** Shpallja e shqyrtimit publik të projekt " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033", bëhet 8 (tetë) ditë para hapjes së tij, përmes mjeteve te informimit publik, faqes zyrtare të komunës dhe në mediat televizive publike dhe lokale.

**Neni 3**

**3.1** Ne shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033",
**3.2.**Në shqyrtimin publik prezantohen fazat e Project " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033", si:
• Informata mbi kornizën Strategjike;
• Profili i Komunës;
• Vlerësimi i gjendjes;
• Korniza e Zhvillimit Hapësinor;
• Pjesa Hartografike;
**3.3** Projekt " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033", i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

**Neni 4**

**4.1** Projekt " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033", i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.
**4.2** Te gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

**Neni 5**

Shqyrtimi i Projekt " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033", organizohet nga Komuna e Klinës në suaza te kompetencave të përcaktuara me ligj.

**Neni 6**

**6.1** Me këtë vendim parashihet sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës se shqyrtimit publik të projekt " Plani Zhvillimor Komunal i Klinës- PZHK 2025-2033",

**6.2** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i organizimit te aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

**Neni 7**

Për zbatimin e këtij vendimi është autoriteti përgjegjës komunal, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit.

**Neni 8**

Vendimi hynë në fuqi pas registrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal bazuar në Ligjin Nr.08/L-284, si dhe pas publikimit në web faqën zyrtare të Komunës.

***Njoftohen:***

- ***MAPL;***
- ***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;***
- ***Kryetari i Komunes;***
- ***Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;***
- ***Zyra për Informim;***
- ***Arkivi.***

**Kryesues i Kuvendit**
**Fadil Gashi**

**RAPORTI I SHQYRTIMIT PUBLIK**

**PZHK (2025-2033)**

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenin 20, si dhe Udhëzimin Administrativ të MMPH 05/2014, si dhe vendimin e Kryetarit të Komunës së Klinës me 01Nr.070-15908/2025 i datës 29.05.2025 , për formimin e Komisionit për Shqyrtimin e kërkesave, vërejtjeve dhe sugjerimeve për Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit publikon Raportin e Shqyrtimit Publik të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës për periudhën 2025- 2033.

Draft Plani Zhvillimor Komunal ka qenë në diskutim publik nga data 23.04.2025 deri më 23.05.2025.

Pjesa grafike dhe pjesa tekstuale e prioriteteve kanë qenë të ekspozuara në sallën e Kuvendit Komunal të Klinës, si dhe në zyrat e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrotje të Mjedisit.

Materialet kanë qenë gjithashtu të disponueshme në adresën elektronike të Komunës së Klinës, si dhe në adresën elektronike të zyrtares pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në zyrën e protokollit dhe fizikisht në zyrat përkatëse të drejtorisë.

Ato kanë qenë në dispozicion të të gjithë të interesuarve për të paraqitur vërejtjet, sugjerimet dhe komentet e tyre gjatë periudhës 30-ditore.Gjatë kësaj kohe, qytetarët kanë dorëzuar 94 kërkesa përmes arkives(zyrës pritesë),

**Raporti i Shqyrtimit Publik për Planin Zhvillimor Komunal**

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, kërkesave dhe sugjerimeve ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha kërkesat, duke iu përgjigjur secilës kërkesë në formë të shkruar .

Falënderojmë të gjithë qytetarët, ekspertët, grupet e interesit, shoqërinë civile, si dhe mediat elektronike dhe lokale, për vërejtjet dhe ndihmën e tyre në pasurimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën tetë (8) vjeçare 2025-2033.

**1.Hapja e diskutimit publik për PZHK-në e Komunës së Klinës**

Bazuar në vendimin e komunës së Klinës për hapjen e diskutimit publik, të datës 26.03.2025, me nr. protokolli 01Nr.-06-8440 / 2025, më **<u>23 prill 2025,</u>** Komuna e Klinës ka bërë hapjen e diskutimit publik për dokumentin e PZHK-së 2025 -2033. Gjatë këtij takimi, para ekipit planifikues komunal, asambleistëve, komunitetit të biznesit dhe qytetarëve, është bërë prezantimi i draft dokumentit të PZHK-së.

Takimi është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal, ku pjesëmarrës ishin: përfaqësues të administratës komunale, asambleistë, përfaqësues të komunitetit të biznesit, shoqëria civile dhe qytetarë të tjerë. Gjithashtu, pjesë e këtij takimi ishin edhe qytetarët nga vendbanimet: Klinë, Dollc, Dresnik, Zajm, Videjë, Polce, Klinfac, Gjurgjevik i Vogël dhe Krushevë e Vogël. Takimi ka filluar në ora 10:00 dhe ka përfunduar në ora 12:00.

**Udhëheqësit e takimit**

<u>Nga Ekipi Komunal:</u>

1. Marqe Selmanaj – Nënkryetare e Komunës së Klinës
2. Enver Berisha- Drejtor i DUMM-Klinë
3. Klementina Qerkinaj – Zyrtare pranë DUMM-Klinë

<u>Nga Kolegji UBT:</u>

1. Hazer Dana
2. Shqiprim Ahmeti

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT

Raporti i shqyrtimit publik pasqyron procesin e zhvilluar në periudhën nga data 23 Prill deri më 23 Maj 2025, gjatë së cilës qytetarët patën mundësinë të paraqesin kërkesat dhe komentet e tyre në kuadër të procesit planifikues. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave, i themeluar me vendim të Kryetarit të Komunës me nr. 01 nr. 070-15908/2025, datë 24.05.2025, ka trajtuar gjithsej 97 kërkesa. Nga analiza e përmbajtjes së tyre, del se shumica e kërkesave kanë qenë të natyrës së shndërrimit të tokës bujqësore në tokë me përdorim të përkohshëm për energji të ripërtëritshme, si dhe në tokë ndërtimore. Ky raport paraqet një përmbledhje të detajuar të shqyrtimit institucional dhe adresimit të propozimeve të qytetarëve, në përputhje me kornizën ligjore dhe planin zhvillimor përkatës.

Sa i përket trajtimit të kërkesave për shndërrimin e tokave bujqësore në toka ndërtimore, dallimet në vendimmarrje janë bazuar në klasifikimin e tokës dhe pozicionin e parcelave në raport me kufijtë e zonës urbane të planifikuar. Kështu, kërkesat që kishin për subjekt toka bujqësore të klasës I–IV të bonitetit dhe që ndodheshin brenda kufirit të ri të planifikuar për zgjerimin e zonës urbane janë aprovuar. Ndërsa, kërkesat për parcela të së njëjtës klasë boniteti që ndodheshin jashtë këtij kufiri janë refuzuar, pasi miratimi i tyre do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar.

Edhe përkundër faktit se totali i sipërfaqeve të aprovuara për shndërrim të tokës bujqësore në tokë me përdorim të përkohshëm për energji të ripërtëritshme i afrohet sipërfaqes prej 1000 hektarësh, shumica e këtyre kërkesave janë aprovuar mbi bazën e arsyetimit se parcelat përkatëse i përkasin klasës V–VIII të bonitetit të tokës, pra toka me potencial të ulët bujqësor. Përjashtim nga ky trajtim kanë përbërë vetëm ato raste në të cilat palët kërkuese kanë paraqitur dokumentacion të plotë, përfshirë pëlqimin mjedisor të lëshuar nga Komuna dhe Ministria përkatëse, duke garantuar përputhshmërinë me politikat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Për të shmangur paqartësitë lidhur me klasifikimin e bonitetit të tokës për parcelat që kanë qenë subjekt i këtyre kërkesave, nga ana e palëve aplikante është kërkuar që ta dëshmojnë klasën e bonitetit përmes fletës poseduese të lëshuar nga institucionet përkatëse kadastrale. Ky dokument zyrtar është marrë si bazë referuese për përcaktimin e saktë të klasës së bonitetit të tokës gjatë shqyrtimit të kërkesave.

## PROCESVERBAL NGA TAKIMI I PARË ME QYTETARËT PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË DRAFT-PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025 – 2033

**Data: 23.04.2025**

**Ora: 10:00**

**Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Klinë**

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Statutin e Komunës së Klinës, dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2014, për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor, si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë takimit të konsultimit publik, dhe është një dokument publik, i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione: në PDF dhe Ëord, si dhe në Arkivin e Komunës, i protokolluar sipas protokollit zyrtar. Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve, të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi, të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna mbi fazën përgatitore të konsultimit publik nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit, të pranishmit janë regjistruar në listën e pjesëmarrësve, duke dhënë emrin, mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Këto të dhëna janë mbledhur për të siguruar evidencën e pjesëmarrjes.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit në formë fizike, si dhe me materialet ku përfshiheshin Hartat dhe Draft-Dokumenti i Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033. Materiali në veçanti është prezantuar në tabelë të mençur ku pamja vizuale ka qenë e qartë dhe e qasshme për qytetarët pjesëmarrës.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka pasur nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

**Takimi filloi në ora 10:00.** Të pranishëm ishin: Nënkryetarja e Komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi - Selmanaj, drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Enver Berisha, përfaqësues nga kompania konsulente - Kolegji UBT, përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, inxhinierë dhe arkitektë komunalë, përfaqësues nga Zyra për Informim në Komunën e Klinës, anëtarë të grupit punues dhe qytetarë.

Takimin e hapi Nënkryetarja e Komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e këtij procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033. Ajo theksoi se ky plan nuk është thjesht një dokument teknik apo formal, është vizion që përcakton drejtimin dhe prioritetet e zhvillimit komunal për tetë vitet e ardhshme.

**Në takim morën pjesë 28 persona, prej të cilëve 5 femra dhe 23 meshkuj.**

*Shtojca nr.1 – Fotografi nga takimi i parë (1) i shqyrtimit publik për DRAFT-PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025 – 2033, në sallën e Kuvendit Komunal, Klinë.*


KUVENDI I KOMUNËS
KLINË - KLINA


KUVENDI I KOMUNËS


KUVENDI I KOMUNËS



Pas fjalimit hyrës të nënkryetares së komunës, një prezantim të agjendës dhe objektivave të takimit e bëri drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Enver Berisha.

Ai potencoi rëndësinë strategjike të Draft Planit Zhvillimor për periudhën 2025–2033 si dokument themelor për orientimin e zhvillimit hapësinor dhe socio-ekonomik të Komunës. Z. Berisha nënvizoi rëndësinë e përfshirjes aktive të qytetarëve në këtë fazë të konsultimeve, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre me komente dhe rekomandime.

Takimi vazhdoi me prezantimin e projektit nga përfaqësuesi i kompanisë konsulente, Kolegji UBT, profesori Hazer Dana.

Profesori Dana prezantoi punën e deritanishme, përfshirë analizën e kontekstit ekzistues, sfidat dhe potencialet e komunës, dhe zhvillimin e skenarëve të mundshëm të zhvillimit. Prezantimi përfshiu fushat e trajtuara në plan (ekonomi, infrastrukturë, mjedis, përdorimi i tokës, planifikim urban, arsim, shëndetësi, kulturë, bujqësi, energji, etj.).
Ai shpjegoi procedurat e ndjekura nga faza e analizës fillestare deri në përgatitjen e draftit.
U paraqitën tre skenarë të mundshëm zhvillimorë, me analizë të hollësishme të përfitimeve dhe kufizimeve të secilit.

Profesori argumentoi profesionalisht përzgjedhjen e Skenarit 3, i cili është vlerësuar si më i qëndrueshëm dhe më i përshtatshëm për zhvillimin afatgjatë të Komunës së Klinës.
Skenari i përzgjedhur u shpjegua në detaje, duke përfshirë komponentët urbanistikë, zhvillimin ekonomik, ruajtjen e burimeve natyrore dhe promovimin e qëndrueshmërisë përmes energjisë së ripërtëritshme dhe menaxhimit të qëndrueshëm të territorit.

Qytetarët u informuan se draft dokumenti do të jetë i publikuar për shqyrtim për një periudhë 30-ditore, gjatë së cilës të gjithë qytetarët kanë të drejtë të paraqesin komente, sugjerime dhe kërkesa. U njoftua gjithashtu se në bashkëpunim me komunitetet lokale, do të organizohen dëgjime publike në të gjitha zonat për të siguruar përfshirjen sa më të gjerë të publikut.

Diskutimi publik dhe komentet e qytetarëve:

Pas prezantimit, drejtori i Urbanizmit hapi sesionin e diskutimit publik,  ku qytetarët patën mundësinë të shprehin mendimet, shqetësimet dhe propozimet e tyre:

**Anton Nikollaj** (**fshati Videjë),**  kërkoi që parcela e tij, që i takon klasave të ulëta të tokës (5-6-7), të kategorizohet si zonë për energji të ripërtëritshme.

**Raif Gashi (fshati Gremnik)**, kërkoi largimin e mbajtëseve rrugore që pengojnë ndërtimin në parcelën e tij, kërkoi qasje në energji elektrike dhe shprehu shqetësimin për tokën që i është marrë për ndërtimin e autostradës.

**Gjergj Marku (fshati Videjë)**, kërkoi që disa toka bujqësore të ri-kategorizohen si zona industriale, duke pasur parasysh potencialin zhvillimor.

**Isa Ibishi (nga Klina)**, ngriti disa shqetësime të rëndësishme, përfshirë problemet me hartat zonale dhe mungesën e ndërhyrjeve nga Ministria e Mjedisit. Ai bëri pyetje lidhur me drejtimet zhvillimore në arsim, shëndetësi dhe industrinë e xehetarisë. Interesim shfaqi për impiantin e ujërave të zeza dhe projektet për energji të ripërtëritshme. Ngriti gjithashtu vështirësitë me distancat ligjore për ndërtim, që

po pengojnë zhvillimin e bujqësisë. Kërkoi një parcelë prej 30 ari e përfshirë në zonë të gjelbër, e parcelizuar në njësi shumë më të vogla.

Përgjigjet nga përfaqësuesit e komunës dhe konsulentët:

Përfaqësuesit e Komunës dhe kompania konsulente ofruan përgjigje të detajuara për çdo çështje të ngritur, duke sqaruar bazën ligjore, kriteret teknike dhe mundësitë për rishikim individual të rasteve të veçanta. U sigurua se të gjitha komentet do të dokumentohen dhe analizohen në mënyrë profesionale për të reflektuar në versionin final të dokumentit.

Pasi përfundoi debati dhe nuk pati më komente, diskutime apo kërkesa nga pjesëmarrësit, drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Enver Berisha, mbylli takimin duke falënderuar të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin dhe gatishmërinë për të kontribuar në një proces planifikues transparent dhe gjithëpërfshirës. Ai theksoi se bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe qytetarëve është thelbësor për një zhvillim të qëndrueshëm dhe harmonik të Klinës.

**Takimi u mbyll në ora 11:17,** në mënyrë të suksesshme me angazhimin për vazhdimin e konsultimeve dhe përgatitjen e versionit përfundimtar të Planit Zhvillimor Komunal.

*Shtojca nr. 2 – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë:*

| | |
|---|---|
| **Femra** | **05** |
| **Meshkuj** | **23** |
| **Totali** | **28** |

## PROCESVERBAL NGA TAKIMI I DYTË ME QYTETARËT PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË DRAFT-PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025-2033

**Data: 25.04.2025**

**Ora: 16:30**

**Vendi: SH.F.M.U "Emin Duraku", Sferkë**

**Ky diskutim u mbajt si pjesë e procesverbalit për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës (2025-2033) për fshatrat: Sferkë, Volljakë, Përçevë, Dush i Vogël, Qupevë e Lartë, Qupevë e Ulët, Gremnik.**

Hapja e takimit u bë nga nënkryetarja e komunës së Klinës, **znj**. **Marqe Selmanaj,** e cila foli për rëndësinë e shqyrtimit publik të draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 për fshatrat e lartpërmendur. Ajo i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe më pas ia kaloi fjalën drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z.Enver Berisha, i cili pas falënderimit të pranishmëve për pjesmarrje theksoi rëndësinë e shqyrtimit publik për draft-dokumentin e PZHK-së 2025-2033 të Komunës së Klinës për fshatrat e lartëcekura.

Fjalën e mori përfaqësuesi i kompanisë konsulente, Kolegji UBT, e kontraktuar për Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Klinës, z.**Hazer Dana,** i cili shpjegoi rëndësinë e Planit Zhvillimor, bazën ligjore të këtij dokumenti në nivelin lokal edhe atë nacional, duke shtjelluar në detaje për secilën zonë. Gjithashtu, profesori Dana ju drejtua të pranishmëve për mundësinë e shqyrtimit të kërkesave dhe mundësinë e debatit të hapur me pjesëmarrësit.

**Sylejman Gashi (fshati Gremnik)**, vlerësoi rëndësinë e këtij dokumenti dhe shprehu shqetësimin për nevojën e mbrojtjes së mjedisit në këto fshatra. Ai theksoi domosdoshmërinë që të diskutohen projektet zhvillimore që prekin këto lokalitete dhe qytetarët e tyre.

**Binak Gashi (fshati Gremnik)**, ngriti çështjen e mbrojtjes së tokave bujqësore dhe nevojën që të parandalohet braktisja e këtyre fshatrave.

**Enver Berisha (drejtor i DUMM – Klinë)**, përsëri mori fjalën dhe potencoi nevojën për mbrojtjen e tokave bujqësore, duke përmendur se ekziston një numër i madh kërkesash për ndryshim destinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.

**Enver Gashi (fshati Gremnik)**, kërkoi informata më të detajuara për tokat sipërfaqësore minerare.

**Fitim Kalludra (fshati Gremnik)**, ngriti çështjen e investimeve në sektorin e turizmit, në veçanti në vendin ku bashkohen lumenjtë Drini dhe Lumëbardhi në Komunën e Klinës.

**Binak Gashi (fshati Gremnik),** ngriti çështjen e sigurisë në këto lokalitete dhe domosdoshmërinë e instalimit të kamerave të sigurisë dhe menaxhimin e tyre nga institucionet komunale.

Dhe si përfundim, **z. Enver Berisha** falënderoi të pranishmit për kontributin e dhënë në debatin për shqyrtimin e draft-dokumentit të PZHK-së për Komunën e Klinës dhe e shpalli të mbyllur takimin.




KLINË
PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL
KLINË 2025-2033

## PROCESVERBAL NGA TAKIMI I TRETË ME QYTETARËT PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË DRAFT-PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2025-2033

**Data: 25.04.2025**

**Ora: 16:30**

**Vendi: SH.F.M.U "Dëshmorët e Qëndresës", Gllarevë**

**Ky diskutim u mbajt si pjesë e procesverbalit për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës (2025-2033) për fshatrat: Gllarevë, Rixhevë, Stapanicë, çabiq, Zabërgjë, Dobërdol, Caravik.**

Takimi u hap nga nënkryetarja e Komunës së Klinës, Marqe Selmanaj, e cila falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe shpalli hapjen e takimit për shqyrtimin publik të draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës 2025-2033, për fshatrat e mësipërm.

**Z. Enver Berisha (drejtor i DUMM),** falënderoi të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e këtij shqyrtimi publik për draft-dokumentin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Klinës, për fshatrat e lartpërmendur.

**Z. Hazer Dana (përfaqësues i kompanisë konsulente të Kolegjit UBT-Prishtinë ),** i kontraktuar për konsulencën e Planit Zhvillimor Komunal, shpjegoi rëndësinë e këtij plani, bazën ligjore të tij dhe detajet e zhvillimit për secilën zonë të fshatrave të përmendura. Ai ftoi të pranishmit për shqyrtimin e mundësive dhe kërkesave të tyre dhe theksoi mundësinë për një debat të hapur.

Kontributi i Pjesëmarrësve:

**Z. Emin Balaj (fshati Gllarevë):** Theksoi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe nevojën për diskutime të thelluara mbi projektet zhvillimore që prekin këto lokalitete. Ai kërkoi gjithashtu zgjerimin e varrezave ekzistuese të fshatit Gllarevë.

**Z. Imer Morina (fshati Rixhevë):** Ngriti shqetësimin për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe theksoi nevojën për të mos lejuar braktisjen e fshatrave. Ai kërkoi që këto takime të jenë më të shpeshta dhe të perfshijnë më shumë banorë të fshatrave.

**Z. Shqiprim Ahmeti (Përfaqësues i Kompanisë Konsulente UBT):** Diskutoi mundësitë për zhvillimin ekonomik dhe investimet në infrastrukturë, si dhe mundësitë për hapjen e profileve të reja, duke u përshtatur me specifikat e secilit lokalitet.

**Z. Enver Berisha (Drejtor i DUMM):** E mori përsëri fjalën dhe theksoi nevojën për mbrojtjen e tokave bujqësore, si dhe nevojën për një organizim më të mirë të banorëve të fshatrave. Ai theksoi rëndësinë e koordinimit dhe adresimit të kërkesave dhe shqetësimeve të banorëve të këtyre fshatrave në institucionet përkatëse komunale.

Në përfundim, **z. Enver Berisha** falënderoi të pranishmit për kontributin e dhënë gjatë debatit për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Klinës dhe shpalli mbylljen e takimit.





**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KATËRT PËR SHQYRTIMIN E DRAFT-DOKUMENTIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË KLINËS 2025-2033**

**Data: 28.04.2025**
**Ora: 16:30**
**Vendi: SH.F.M.U. "Atë Shtjefën Gjeçovi"- Zllakuqan**

**Takimi u mbajt për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës 2025-2033 për fshatrat: Zllakuqan, Pataqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Krushevë e Madhe, Budisalc, Rudicë dhe Jagodë.**

Takimi u hap nga z. Enver Berisha, i cili theksoi rëndësinë e dokumentit gjithëpërfshirës të Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 për Komunën e Klinës, për fshatrat Zllakuqan, Pataqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Krushevë e Madhe, Budisalc, Rudicë dhe Jagodë. Ai foli për nevojën e debatit të hapur me qytetarët, që të mund të ngriten shqetësimet dhe kërkesat e tyre lidhur me planin zhvillimor.
Pas fjalës hyrëse, z. Berisha falënderoi pjesëmarrësit dhe i kaloi fjalën përfaqësuesit të kompanisë konsulente të Universitetit UBT-Prishtinë, z. Hazer Dana.

**Z. Hazer Dana** shpjegoi rëndësinë e planit zhvillimor dhe bazën ligjore të këtij dokumenti, si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar. Ai elaboroi detajet për secilën zonë dhe theksoi mundësinë e shqyrtimit të kërkesave dhe mundësinë për një debat të hapur.
Kontributet e Pjesëmarrësve:

**Mark Gojani (fshati Budisalc):** Shprehu shqetësimet mbi mbrojtjen e mjedisit dhe nevojën për bashkimin e shkollave të fshatrave për të krijuar një shkollë të vetme për të gjithë nxënësit, duke theksuar se numri i nxënësve është i vogël. Gjithashtu,

ai ngriti çështjen e varrezave të fshatit Budisalc, të cilat përfshijnë varreza ortodokse dhe të komuniteteve egjiptiane dhe rome, dhe kërkoi definimin e varrezave të Nagllavës dhe Krushevës së Madhe.

**Kristë Selmanaj ( fshati Radulloc):** Trajtoi çështjen e mbrojtjes së tokave bujqësore, duke kërkuar mbrojtjen e këtyre tokave nga ndotja e ujërave të zeza që derdhen në Drinin e Bardhë nga deponia e mbeturinave rajonale.

**Lorik Haxhiu (Drejtor i Kompanisë Solariss L.L.C):** Paraqiti shqetësimin e tij për ndërtimin e një parku solar për energji të ripërtëritshme në fshatin Berkovë. Ai kërkoi që zona kadastrale e Berkovës të përfshihet në listën e zonave ku parashihet shfrytëzimi i përkohshëm për energji të ripërtëritshme, siç është përmendur në draft-dokumentin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2032, në kapitullin 4.3.3.3, i cili trajton energjinë elektrike dhe termike.

**Z. Enver Berisha** mori fjalën përsëri dhe theksoi rëndësinë e mbrojtjes së tokave bujqësore dhe nevojën për koordinimin dhe adresimin e shqetësimeve të banorëve në institucionet komunale. Ai theksoi se është e domosdoshme të organizohen më mirë banorët e këtyre fshatrave për të garantuar përfshirjen dhe mbështetjen e kërkesave të tyre.

Në përmbyllje, **z. Enver Berisha** falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë gjatë debatit dhe shpalli takimin të mbyllur.





**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I PESTË PËR SHQYRTIMIN E DRAFT-DOKUMENTIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË KLINËS 2025-2033**

**Data: 28.04.2025**

**Ora: 16:30**

**Vendi:SH.F.M.U. "Tre Dëshmorët", Jashanicë**

**Takimi u mbajt për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës 2025-2033 për fshatrat: Jashanicë e Ulët, Jashanicë e Epërme, Siqevë, Jelloc, Ujmirë, Shtaricë, Pograxhë, Resnik, Dush, Shtupel, Kërrnicë, Binxhë, Grabc.**

Takimi u hap nga z. Enver Berisha, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Klinës. Ai theksoi rëndësinë e dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal dhe nevojën për një debat të hapur me qytetarët për të ngritur shqetësimet dhe kërkesat e tyre lidhur me shqyrtimin publik të draft-dokumentit për periudhën 2025-2033, i cili mbulon fshatrat e lartpërmendur.

Z. Berisha theksoi se ky plan zhvillimor është një hap i rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të komunës dhe kërkoi që të gjithë qytetarët të kontribuojnë aktivisht në këtë proces.

Z. Enver Berisha, duke falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, theksoi rëndësinë e shqyrtimit publik të draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës. Ai inkurajoi të gjithë banorët e fshatrave të përfshirë që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre, duke theksuar se ky proces është mundësia për të reflektuar mbi nevojat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës.

Fjalën e mori **z. Hazer Dana**, përfaqësues i kompanisë konsulente UBT, e kontraktuar për hartimin dhe implementimin e Planit Zhvillimor Komunal. Ai shpjegoi rëndësinë e planit dhe bazën ligjore të tij, duke përmendur legjislacionin në nivel lokal dhe kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin e nevojave të qytetarëve.

Z. Dana sqaroi detajet e planit për secilin fshat të përfshirë, duke nxjerrë në pah veçoritë dhe prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës, mjedisit dhe sektorëve të tjerë të rëndësishëm. Ai theksoi se ky dokument është një udhëzues për zhvillimin afatgjatë dhe mbështetjen e qytetarëve dhe fshatrave të përfshirë.

Diskutimet e banorëve:

**Z. Kushtrim Haliti (fshati Jashanicë e Ulët):** Vlerësoi rëndësinë e draft-dokumentit dhe mundësinë për të shprehur shqetësimet e tij lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm në fshatra. Ai ngriti çështjen e furnizimit me ujë për disa lagje të fshatit Jashanicë, që varen nga pusi i Jarinjes, dhe theksoi nevojën për mbrojtjen e tokave bujqësore, si dhe kërkoi që projekti të fokusohet në mbështetje të infrastrukturës së ujit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

**Z. Ukë Rugani ( fshati Jashanicë e Epërme):** Ngriti çështjen e sistemit të kanalizimit, duke theksuar vështirësitë që kanë disa shtëpi për t'u lidhur me rrjetin e kanalizimit. Ai kërkoi që të merren masa për të zgjidhur këto probleme dhe për të siguruar shërbime më të mira për banorët e fshatit.

**Z. Berisha** mori përsëri fjalën, duke theksuar se një nga prioritetet kryesore është ngritja e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, për të zgjidhur problemet që kanë fshatrat, sidomos Jashanica. Ai gjithashtu theksoi rëndësinë e mbrojtjes së tokave bujqësore dhe u angazhua për një koordinim më të mirë me banorët për të adresuar shqetësimet e tyre.

**Z. Dana** ndërhyri dhe shpjegoi se dokumenti i Planit Zhvillimor është multidisiplinar dhe strategjik, duke përfshirë aspekte të zhvillimit urban, mjedisit dhe ekonomisë. Ai u bëri thirrje të pranishmëve që të japin sugjerime dhe mendime për përmirësimin e dokumentit, duke e konsideruar këtë si mundësi për të kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm dhe giithëpërfshirës.

Në fund të takimit, z. Enver Berisha falënderoi të pranishmit për kontributin e tyre në këtë proces shqyrtimi dhe shpalli takimin të mbyllur, duke theksuar se shqyrtimi i dokumentit do të vazhdojë me përfshirjen e plotë të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Ai theksoi se ky plan është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të Komunës së Klinës dhe ka nevojë për mbështetje të secilit qytetar.



**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I GJASHTË PËR SHQYRTIMIN E DRAFT-DOKUMENTIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË KLINËS 2025-2033**

**Data: 30.04.2025**

**Ora: 16:30**

**Vendi: SH.F.M.U "Azem Bejta", Grabanicë**

**Takimi u mbajt për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës 2025-2033 për fshatrat: Grabanicë, Dollovë, Qeskovë, Këpuz, Bokshiq, Dugajevë, Drenoc, Pjetërq i Epërm dhe Pjetërq i Ulët.**

Takimi u mbajt për shqyrtimin e draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës 2025-2033 për fshatrat: Grabanicë, Dollovë, Qeskovë, Këpuz, Bokshiq, Dugajevë, Drenoc, Pjetërq i Epërm dhe Pjetërq i Ulët.

Takimi u hap nga z. Enver Berisha, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Klinës. Ai theksoi rëndësinë e dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal dhe nevojën për një debat të hapur me qytetarët për të ngritur shqetësimet dhe kërkesat e tyre lidhur me shqyrtimin publik të draft-dokumentit për periudhën 2025-2033, i cili mbulon fshatrat e lartpërmendur. Z. Berisha theksoi se ky plan zhvillimor është një hap i rëndësishëm për zhvillimin afatgjatë të komunës dhe kërkoi që të gjithë qytetarët të kontribuojnë aktivisht në këtë proces.

Z. Enver Berisha, duke falënderuar të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre, theksoi rëndësinë e shqyrtimit publik të draft-dokumentit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës. Ai inkurajoi të gjithë banorët e fshatrave të përfshirë që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre, duke theksuar se ky proces është mundësia për të reflektuar mbi nevojat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës.

**Xhevahire Miftari Klopne ( fshati Pjetërq i Epërm, me vendbanim në Prishtinë):** Kërkesa e saj konkrete ishte që dy parcelat me nr. 00097/1 dhe 00097/2 në zonën kadastrale Pjeterq i Epërm, aktualisht të klasifikuara si tokë bujqësore, të kalojnë në tokë ndërtimore për ndërtimin e shtëpisë së banimit.

Fjalën e mori **z. Hazer Dana**, përfaqësues i kompanisë konsulente UBT, e kontraktuar për hartimin dhe implementimin e Planit Zhvillimor Komunal. Ai shpjegoi rëndësinë e planit dhe bazën ligjore të tij, duke përmendur legjislacionin në nivel lokal dhe kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin e nevojave të qytetarëve.

**Z. Fadil Berisha (fshati Qeskovë):** Potencoi problemet me të cilat haset kjo bashkësi lokale në aspektin e sigurimit të ujit të pijshëm dhe problemet me degradimin e tokës bujqësore. Ai pyeti përfaqësuesin e UBT-së për kahjet e zhvillimit të komunës së Klinës dhe drejtimin që do të marrë zhvillimi i qendrës së komunës.

Fjalën e mori përsëri **z.Dana** duke elaboruar në detaje Planin Zhvillimor Komunal të Klinës.
Z. Dana sqaroi detajet e planit për secilën lagje të përfshirë, duke nxjerrë në pah veçoritë dhe prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës, mjedisit dhe sektorëve të tjerë të rëndësishëm. Ai theksoi se ky dokument është një udhëzues për zhvillimin afatgjatë dhe mbështetjen e qytetarëve dhe fshatrave të përfshirë.

**Z. Regjep Rama ( fshati Pjetërq i Poshtëm):** Kërkoi që prona e cila është e evidentuar në emër të Arton Ramës me nr.00018-1 z.k. Pjetërq i Ulët, të kalojë nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

**Reagimi i z. Enver Berisha:** Kërkesa është që parcela nr. 00018-1 në zonën kadastrale Pjetërq i Ulët, e evidentuar në emër të Arton Ramës, të kalojë nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.

**Mustafë Binaku (fshati Bokshiq)**: Kërkoi subvencione për blegtori, me kërkesën që të mos kufizohen numri i deleve dhe lopëve.

**Z. Enver Berisha (drejtori i DUMM):** Ai mori përsëri fjalën dhe theksoi se një nga prioritetet kryesore të Komunës së Klinës është përkrahja e bujqve të kësaj zone me mjete dhe mekanizma bujqësorë, për t'u dalë në ndihmë bujqëve të kësaj bashkësie lokale. Po ashtu, ai theksoi rëndësinë e mbrojtjes së tokave bujqësore dhe u angazhua për një koordinim më të mirë me banorët për adresimin e shqetësimeve të tyre.

**Z. Dana** ndërhyri duke shpjeguar se dokumenti i Planit Zhvillimor është multidisiplinar dhe strategjik, duke përfshirë aspekte të zhvillimit urban, mjedisit dhe ekonomisë. Ai u bëri thirrje të pranishmëve që të japin sugjerime dhe mendime për përmirësimin e dokumentit, duke e konsideruar këtë si një mundësi për të kontribuar në një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Në fund të takimit, **z. Enver Berisha** falënderoi të pranishmit për kontributin e tyre në këtë proces shqyrtimi dhe shpalli takimin të mbyllur, duke theksuar se shqyrtimi i dokumentit do të vazhdojë me përfshirjen e plotë të qytetarëve dhe grupeve të interesit. Ai nënvizoi se ky plan është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të Komunës së Klinës dhe ka nevojë për mbështetje nga të gjithë.

**Shqiprim Ahmeti (përfaqësues i kompanisë konsulente nga UBT):** Mori fjalën në diskutimin për mundësitë e zhvillimit ekonomik dhe investimet në infrastrukturë si dhe mundësitë për hapjen e profileve të reja duke u përshtatur specifikave të këtij lokaliteti.

**Enver Berisha (drejtor i DUMM – Klinë):** Përsëri e mori fjalën duke potencuar nevojën e mbrojtjes së tokave bujqësore si dhe organizimin më të mirë të banorëve të këtyre fshatrave për domosdoshmërinë e koordinimit dhe adresimin e shqetësimeve dhe kërkesave të banorëve të këtyre fshatrave në institucionet përkatëse komunale.

Dhe si përfundim, ai falënderoi të pranishmit për kontributin në debatin për shqyrtimin e draft-dokumentit të PZHK-së për komunën e Klinës, duke e shpallur të mbyllur këtë takim .





## Kërkesat me shkrim të dërguara nga qytetarët përmes fletores, emailit apo protokollit

| Nr | Nr.prot | Emri dhe Mbiemri i parashtruesit | Vërejtje, propozim, sugjerim, kërkesë | Arsyetimi I komisionit |
|---|---|---|---|---|
| 1. | 06-312-12693/25<br>29.04.2025 | **8TËENTY ENERGY SH.P.K** | 8TËENTY ENERGY" SH.P.K., me seli në Prishtinë dhe NUI 811906463, të cilën e përfaqëson z. Burim Muharremi, është në fazën e marrjes së Kushteve Ndërtimore nga MMPHI për fillimin e projektit ndërtimor lidhur me ndërtimin e Parkut Solar 100 MËp në Zllakuqan, në ngastrat komunale: P-71006011-00280-3; Dranashiq, 762133 m²; P-71006059-00001-15; Shtupel, 155072 m²; P-71006011-00111-1; Dranashiq, 160028 m²;<br>P-71006011-00312-1; Dranashiq, 150114 m²; P-71006011-00372-2; Dranashiq, 126811 m²; P-71006059-00001-16; Shtupel, 16470 m².Parcelat kadastrale të lartëcekura do të përdoren me qëllim të ndërtimit të Parkut Solar – Impiantit Fotovoltaik me kapacitet 100 MËp. Kompania ka marrë Pëlqimin Mjedisor (VNM) me numër 6333-2/22, datë 23.01.2023, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). Sipas VNM, tokat në të cilat do të bëhet Parku Solar janë të gjitha kategori pesë (5) e lartë, prandaj kërkohet nga ana e komunës që të rishikohen parcelat dhe të vazhdohet me përfshirjen e Parkut Solar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK). | **Aprovohet** kërkesa e palës që parcelat e permendura brenda zonave kadastrale Zlllakuçan, Dranashiq dhe Shtupel të përfshihen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme.<br>**Arsyetim:** Sipas Çertifikateve të Pronësisë (kopjet e bashkangjitura) tokat në fjalë u takojnë kategorive 5, 6 të bonitetit të tokës.<br>**Sqarim shtesë**: këto zona kanë që të pëfshira në draftin e pzhk-2025-33 paraprak, mirëpo janë hequr nga drafti për shkak të paqartësive paraprake mbi klasën (bonitetin) e tokës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2. | 06-463-14333/25<br>14.05.2025 | **Dukagjin Solar Sferkë 04 LLC** | Kompania DUKAGJIN SOLAR SFERKË 04 L.L.C është në proces të përgatitjes së aplikimit për Kushtet Ndërtimore të projektit të klasifikuar të kategorisë III në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ndërtimin e projektit "Parku Solar Dukagjin", pjesë e të cilit shtrihet në Komunën e Klinës, në Zonat Kadastrale Nagllavë dhe Budisalc.<br>Projekti parashihet të jetë në operim gjatë vitit 2026 dhe do të ketë jetëgjatësi operacionale prej 30 + 10 vite.<br>Kërkojmë ndërrimin e përkohshëm të destinimit të tokës bujqësore në tokë jobujqësore për parcelën nr. 00050-15, ZK Nagllavë, vendin e quajtur "Pavada", respektivisht për vendosjen e paneleve solare për prodhim të energjisë së ripërtëritshme, konform Ligjit për Tokën Bujqësore dhe në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, paragrafi 13.1, nënparagrafi b), dhe paragrafi 13.3, si dhe konform Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, paragrafi 6.5.<br>Bashkëngjitur kësaj kërkese janë:Projekti i Ri-Kultivimit për parcelat nr. 00001-6 dhe nr. 00179-1, ZK Budisalc dhe nr. 00050-15, ZK Nagllavë, Komuna e Klinës; Kërkesë DBZHR Klinë për ndërrimin e kulturës bujqësore, datë 25.02.2025, nr. Protokolli 07-320-5748/25; Vërtetim Urbanistik nga DUMM Klinë, datë 07.03.2024, nr. Protokolli 06-350-3511/24 për parcelat nr. 00001-6 dhe nr. 00179-1, ZK Budisalc dhe nr. 00050-15, ZK Nagllavë, Komuna e Klinë; Pëlqim Mjedisor nr. 22/5121 nga MMPHI për parcelën nr. 00050-15, ZK Nagllavë, Komuna e Klinës | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura brenda zonave kadastrale Nagllavë dhe Budisalc të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme.<br><br>**Arsyetim:** Sipas Çertifikatevr të Pronësisë (kopjet e bashkangjitura) tokat në fjalë u takojnë kategorive 5, 6 të bonitetit të tokës.<br>**Sqarim shtesë**: kto zona kanë që të pëfshira në draftin e pzhk-2025-33 paraprak, mirëpo janë hequr nga drafti për shkak të paqartësive paraprake mbi klasën (bonitetin) e tokës. |
| 3. | 06-312-14326/25<br>14.05.2025 | **Dukagjin Solar Sferkë 04 LLC** | Kompania DUKAGJIN SOLAR SFERKË 04 L.L.C. ri-kërkon përfshirjen e parcelave nr. 00050-15, ZK Nagllavë dhe nr. 00001-6, 00179-1, ZK Budisalc në Planin Zhvillimor Komunal të Klinës (PZHK) për periudhën 2025 - 2033.<br>Arsyetimi: Nga informacionet e marrë nga materiali i publikuar i draft-PZHK në faqen zyrtare të komunës, parcelat e sipërpërmendura nuk figurojnë në hartën ku parashihen projektet për energjinë e ripërtëritshme. Andaj, ju lutemi që këto parcela të ri-kthehen dhe përfshihen në PZHK 2025-2033 si zona të | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura brenda zonave kadastrale Nagllavë dhe Budisalc të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | parapara për zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme.<br>Kompania DUKAGJIN SOLAR SFERKË 04 L.L.C. është kompani në pronësi të investitorëve të huaj dhe që nga viti 2021 po investon në ndërtimin e parkut solar, i cili do të shtrihet në zonën ndërkufitare të komunave Pejë dhe Klinë. Kompania ka marrë tashmë Kushtet Ndërtimore nga MMPHI për pjesën e parkut solar që shtrihet në Komunën e Pejës dhe prej 1 viti është në pritje të miratimit të PZHK-së së Klinës, në mënyrë që të amandamentojë Kushtet Ndërtimore edhe për pjesën e projektit që shtrihet në Komunën e Klinës.<br>Bashkëngjitur kërkesës janë: Kërkesa nga DSS për përfshirje në PZHK Klinë, datë 01.02.2024, nr. protokolli 06-350-3513/24 për parcelat nr. 00001-6 dhe nr. 00179-1, ZK Budisalc dhe nr. 00050-15, ZK Nagllavë, Komuna e Klinës;Vërtetim Urbanistik nga DUMM Klinë, datë 07.03.2024, nr. protokolli 06-350-3511/24 për parcelat nr. 00001-6 dhe nr. 00179-1, ZK Budisalc dhe nr. 00050-15, ZK Nagllavë, Komuna e Klinës;<br>Pëlqim Mjedisor nr. 21/5385 nga MMPHI për parcelat nr. 00001-6 dhe nr. 00179-1, ZK Budisalc, Komuna e Klinës dhe transfer i Pëlqimit Mjedisor nr. 23/4030 nga MMPHI; Pëlqim Mjedisor nr. 22/5121 nga MMPHI për parcelën nr. 00050-15, ZK Nagllavë, Komuna e Klinës. | **Arsyetim:** Sipas Çertifikatevr të Pronësisë (kopjet e bashkangjitura) tokat në fjalë u takojnë kategorive 5, 6 të bonitetit të tokës.<br>**Sqarim shtesë**: kto zona kanë që të pëfshira në draftin e pzhk-2025-33 paraprak, mirëpo janë hequr nga drafti për shkak të paqartësive paraprake mbi klasën (bonitetin) e tokës. |
| 4. | 06-351-13195/25<br>02.05.2025 | **Imer Elezaj** | Duke u bazuar në planet tona afatgjata dhe me marrjen e informacionit që Komuna e Klinës është duke e hartuar Planin Zhvillimor të ri, bëjë kërkesë për ndërrimin e destinimit të parcelave të cilat janë në pronësi timen dhe të familjarëve të mi.Parcelat në fjalë janë për momentin të destinuara për tokë bujqësore. Pozicioni i tyre është shumë i përshtatshëm për vendosje të paneleve solare, sepse të gjitha këto parcela janë në pozicion të kthyera kah jugu dhe si të tilla kanë diellosje maksimale.<br>Po ashtu, edhe klasa e tokës është klasë e 5-të, që është njëri nga kushtet kryesore për ndërtim të parqeve energjetike (solare).Meqenëse në të ardhmen fokusi në prodhimin e energjisë së ripërtritshme është duke u shtuar me ritme të | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme.<br>**Arsyetim:** Tokat në fjalë u takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | shpejta, unë kërkoj që kjo tokë, përveç shfrytëzimit si tokë bujqësore, të bëhet edhe tokë e ndërtimit për parqe energjetike apo solare. Këto janë parcelat për të cilat bëhet kërkesa:<br>00159-5, 00159-6, 00159-7, 00159-8, 00159-11, 00159-12, 00159-13 dhe 00159-14 në zonën kadastrale Zllakuqan, Komuna e Klinës.<br>00082-88, 00082-87, 00082-86, 00082-90 dhe 00082-91 në zonën kadastrale Klinë, Komuna e Klinës.<br>00001-9 në zonën kadastrale Klinavc, Komuna e Klinës. | |
| 5. | 06-312-11721/25<br>23.04.2025 | **Anton Nikollaj** | Z. Anton Nikollaj është pronar i parcelave P-71011014-00677-2; P-71011027-00001-214; P-71011027-00001-349; P-71011027-00001-365; P-71011027-00001-361; P-71011027-00001-369; P-71011027-00001-431; P-71011027-00001-101; të gjitha në ZK Pjetërq i Ulët në Komunën e Klinës. Përmes kësaj kërkese, Z. Anton Nikollaj kërkon nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, parcelat e sipërshënuara të përfshihen si zonë e dedikuar për ndërtimin e Parkut Solar, përkatësisht për gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme.Parcelat e sipërshënuara plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie, nuk pengojnë komunitetin e zonës përreth dhe do të kontribuojnë në zhvillimin biznesor të asaj zone, si dhe të Komunës së Klinës.Z. Anton Nikollaj deklaron se ka projektuar një koncept mbi shfrytëzimin e parcelave dhe disponon kapacitetin financiar për implementimin e projektit, i cili kontribuon vetëm në të mirë të Komunës së Klinës, pa cënuar legjislacionin për Mbrojtjen e Ambientit dhe Mjedisit.Prandaj, përmes kësaj shkrese, kërkohet nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, parcelat e sipërshënuara të përfshihen si zonë e dedikuar për ndërtimin e parkut solar, | **Kerkesa e pales aprovohet pjesërisht.**<br>Parcelat të cilat aprovohen të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme , e të cilat i takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës janë :<br>P-71011014-00677-2; P71011027-00001-214; 71011027-00001-349;-71011027-00001-365<br>P-71011027-00001-369;<br>P-71011027-00001-361 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | përkatësisht gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme. Lidhur me këtë ndryshim, brenda afatit të përcaktuar ligjor, kërkohet që të mbahemi të njoftuar. | **Refuzohet kërkesa për ndërrim të destinimit për parcelën**<br><br>P-71011027-000001-431me arsyetimin se kjo parcelë është arë dhe i takon kategorisë 2 të bonitetit të tokës<br><br>**Refuzohet kërkesa për ndërrim të destinimit për parcelën**<br><br>P-71011027-00001-101 me arsyetimin se kjo parcele është rrugë e pa-kategorizuar si dhe pronë shoqërore. |
| 6. | 06-312-11721/25<br><br>23.04.2025 | **Bislim Bajrami** | Bislim Bajrami është qiramarrës për 99 vite i parcelës P-71011027-00001-396, e cila ndodhet në ZK Pjetërq i Ulët, në vendin e quajtur "Kaproishte", Komuna e Klinës. Përmes kësaj kërkese, Bislim Bajrami kërkon nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, parcela e sipërshënuar të përfshihet si zonë e dedikuar për ndërtimin e Parkut Solar, përkatësisht për gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme. Parcela e sipërshënuar plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie, nuk pengon komunitetin e zonës përreth dhe do të kontribuojë në zhvillimin biznesor të asaj zone, si dhe të Komunës së Klinës.Bislim Bajrami deklaron se ka projektuar një koncept mbi shfrytëzimin e parcelës dhe disponon kapacitetin | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme.<br><br>**Arsyetim:** Tokat në fjalë u takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | financiar për implementimin e projektit, i cili kontribuon vetëm në të mirë të Komunës së Klinës, pa cënuar legjislacionin për Mbrojtjen e Ambientit dhe Mjedisit. Prandaj, përmes kësaj shkrese, kërkohet nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, parcela e sipërshënuar të përfshihet si zonë e dedikuar për ndërtimin e parkut solar, përkatësisht gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme. Lidhur me këtë ndryshim, brenda afatit të përcaktuar ligjor, kërkohet që të mbahemi të njoftuar. | |
| 7. | 06-942-12297/25<br>25.04.2025 | **Gazmend Kajtazi** | Gazmend Kajtazi është qiramarrës për 99 vite i parcelave P-71011027-00001-382, P-71011027-00001-383, P-71011027-00001-399, të gjitha të ndodhura në ZK Pjetërq i Ulët, në vendin e quajtur "Kaproishte", Komuna e Klinës. Përmes kësaj kërkese, Gazmend Kajtazi kërkon nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, parcelat e sipërshënuara të përfshihen si zonë e dedikuar për ndërtimin e Parkut Solar, përkatësisht për gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme.Parcelat e sipërshënuara plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie, nuk pengojnë komunitetin e zonës përreth dhe do të kontribuojnë në zhvillimin biznesor të asaj zone, si dhe të Komunës së Klinës.Gazmend Kajtazi deklaron se ka projektuar një koncept mbi shfrytëzimin e parcelave dhe disponon kapacitetin financiar për implementimin e projektit, i cili kontribuon vetëm në të mirë të Komunës së Klinës, pa cënuar legjislacionin për Mbrojtjen e Ambientit dhe Mjedisit.Prandaj, përmes kësaj shkrese, kërkohet nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale, parcelat e sipërshënuara të përfshihen si zonë e dedikuar për ndërtimin e parkut solar, përkatësisht gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme. Lidhur me këtë ndryshim, brenda afatit të përcaktuar ligjor, kërkohet që të mbahemi të njoftuar. | **Kerkesa e pales aprovohet pjesërisht.**<br>Parcelat të cilat aprovohen të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme , e të cilat i takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës janë:<br>00001-382 zk. Petriq i ulet<br>00001-383 zk. Petriq i ulet<br>**Refuzohet kërkesa për ndërrim të destinimit për parcelën** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 00001-399 ZK Petriq i Ulet me arsyetimin se kjo parcelë i takon kategorisë 2 të bonitetit të tokës.<br><br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 8. | 06-942-12303/25<br><br>25.04.2025 | **Bau Holding L.L.C** | "Bau Holding" L.L.C është qerambajtës për 99 vite i parcelave P-71011027-00001-206; P-71011027-00001-209; P-71011027-00001-221; P-71011027-00001-223; P-71011027-00001-367; P-71011027-00001-379; P-71011027-00001-380; P-71011027-00001-381; P-71011027-00001-384; P-71011027-00001-385; P-71011027-00001-386; P-71011027-00001-387; P-71011027-00001-388; P-71011027-00001-389; P-71011027-00001-390; P-71011027-00001-391; P-71011027-00001-392; P-71011027-00001-393; P-71011027-00001-394; P-71011027-00001-395; P-71011027-00001-397; P-71011027-00001-398; P-71011027-00001-400; P-71011027-00001-401; P-71011027-00001-402; P-71011027-00001-403; P-71011027-00001-404; P-71011027-00001-405; P-71011027-00001-406; P-71011027-00001-407; P-71011027-00001-408; P-71011027-00001-409; P-71011027-00001-410; P-71011027-00001-411; P-71011027-00001-412; P-71011027-00001-413; P-71011027-00001-414; P-71011027-00001-415; P-71011027-00001-416; P-71011027-00001-417; P-71011027-00001-418; P-71011027-00001-419; P-71011027-00001-420; P-71011027-00001-421; P-71011027-00001-422; P-71011027- | **Kerkesa e pales aprovohet pjesërisht.**<br><br>Parcelat të cilat aprovohen të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme , e të cilat i takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës janë:<br><br>00001-206 ,00001-379,00001-380,0001-381,00001-384,00001-385,00001-386,00001-387,00001-388,00001-389,0000390,00001- |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 00001-423, të gjitha në ZK Pjetërq i Ulët, në vendin e quajtur “Kaproishte” në Komunën e Klinës. Përmes kësaj kërkese "Bau Holding" L.L.C kërkon nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis, që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartimit të Hartës Zonale parcelat e sipërshënuara t'i përfshijë si zonë e dedikuar për ndërtim të parkut solar, përkatësisht gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme. Parcelat e sipërshënuara i plotësojnë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme, nuk pengojnë komunitetin e zonës përreth dhe do të kthehen edhe në interes të zhvillimit biznesor të asaj zone, përkatësisht edhe të Komunës së Klinës. "Bau Holding" L.L.C deklaron se ka projektuar një koncept mbi shfrytëzimin e parcelave në fjalë dhe ka kapacitetin financiar që të implemetojë projektin, i cili kontribuon vetëm në të mirë të Komunës së Klinës, pa atakuar legjislacionin më të cilin përcaktohet Mbrojtja e Ambientit dhe Mjedisit. | 391,00001-392,00001-393,00001-394,00001-395,00001-397,00001-398,00001-00001-412,00001-413,0001-414,00001-415,00001-416,00001-417,00001-418,00001-419,00001-420,00001-421,00001-422,00001-423. Te gjitha kto parcela gjenden ne ZK Petriq i ulet.<br><br>**Refuzohet kërkesa për ndërrim të destinimit për parcelat e më poshtme,** me arsyetimin se këto parcela i takojnë kategorisë 2 të bonitetit të tokës:<br><br>00001-209,00001-221,00001-223,00001-367,00001-400,00001-401,00001-402,00001-403,00001-404,00001-405,00001-406,00001-407,00001-408,00001-409,00001-410,00001-411.<br><br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 9. | 06-312-12291/25<br>25.04.2025 | **Gerbeland SH.P.K** | Kërkesë për vendosjen e zonës së parkut solar në planin zhvillimor urban dhe hartën zonale. I/E nderuar, përmes kësaj shkrese, kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe Kuvendi Komunal i Klinës dhe Drejtoritë tjera përkatëse, që në zonën e paraqitur me skicë dhe koordinata në shtojcën nr. 1 të përfshihet në planin zhvillimor urban dhe në hartën zonale, si zonë e destinuar për ndërtimin e parkut solar, respektivisht për gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme. Ne, si kompani jemi të interesuar që të bëjmë një investim në fushën e energjisë solare, respektivisht për gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme në kuader të njësisë kadastrale me nr. P-71006004-00416-3, zona kadastrale Berkovë. Një investim i tillë do të ndikojë direkt në zhvillimin ekonomik të KK Klinë dhe vendit në përgjithësi. Andaj, lejimi dhe përfshirja e kësaj zone në planin zhvillimor urban dhe në hartën zonale do të jetë i një rëndësie të veçantë. Ne, si kompani jemi të hapur për çdo bashkëpunim dhe për çdo informatë tjetër apo dokumentacion shtesë, ne jemi në dispozicion tuaj. Mbesim me shpresë në mirëkuptimin tuaj, duke parë rëndësinë e këtij investimi dhe interesat e KK Klinë dhe Republikës së Kosovës. | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme.<br>**Arsyetim:** Tokat në fjalë u takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës. |
| 10. | 06-312-12246/25<br>25.04.2025 | **Ahmet Haxha** | LËNDA: Kërkesë për vendosje të parkut solar në zonën kadastrale Dush i Vogël-Komuna e Klinës, në dokumentet e planifikimit hapësinor. Të nderuar Dr. Zenun Elezaj dhe z. Enver Berisha, ju drejtohem si pronar Ahmet Haxha me banim në Klinë. Qëllimi im kryesor është që, toka ime, që është tokë bujqësore e klasës gjashtë (6), të futet në PZHK dhe në hartat Zonale si tokë industriale ose ndërtimore në Klinë. Kërkoj nga ky organ që ngastrat kadastrale siç janë: P- | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 71006015-00674-2 dhe P-71006015-00674-7, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Dush i Vogël, Komuna e Klinës, të përfshihen në këtë ndryshim. Kësaj kërkese ia bashkojmë certifikatën e pronës, kopjen e planit dhe kopjen e letërnjoftimit. Mirëpresim shqyrtimin e kërkesës sonë nga ana e juaj. | **Arsyetim:** Tokat në fjalë u takojnë kategorisë 5 të bonitetit të tokës. |
| 11. | 06-312-12245/25<br><br>25.04.2025 | **Minire Gecaj** | LËNDA: kërkesë për vendosje të parkut solare ne Zonën kadastrale Dush i Vogël, Komuna e Klinës, në dokumentet e planifikimit hapësinore.<br><br>I nderuar Dr. Zenun Elezaj dhe Z. Enver Berisha.<br><br>Ju drejtohem si pronarë Ahmet Haxha me banim në Klinë. Qillimi im kryesore eshtë që toka ime eshtë toke bujqesore e klasës 6, që te futet në PZHK dhe ne hartat Zonale ne si tokë industriale ose ndërtimore ne Klinë. Kërkoj nga ky organ që ngastrat kadastrale siç jane: P-71006015-00674-5 dhe P-71006015-00674-8, që të dyja ndodhën në zonën kadastrale në Dush i Vogël, Komuna e Klines. Kesaj kërkesë ia bashkojme Certifikatën e Pronës, kopjen e planit dhe kopjen e letërnjoftimi. Mirëpresim shqyrtimin e kerkesës tonë nga ana e juaj | **Aprovohet kërkesa** me arsyetimin se parcelat në fjalë u takojnë kategorive V-VIII të bonitetit të tokës. |
| 12. | 06-312-12247/25<br><br>25.04.2025 | **Kastriot Gecaj** | LËNDA: Kërkesë për vendosje të parkut solar në zonën kadastrale Dush i Vogël- Komuna e Klinës, në dokumentet e planifikimit hapësinor. Të nderuar Dr. Zenun Elezaj dhe Z. Enver Berisha, ju drejtohem si pronar Ahmet Haxha me banim në Klinë. Qëllimi im kryesor është që, toka ime, që është tokë bujqësore e klasës gjashtë (6), të futet në PZHK dhe në hartat Zonale, si tokë industriale ose ndërtimore në Klinë. Kërkoj nga ky organ që ngastrat kadastrale siç janë: P-71006015-00251-3, P-71006015-00252-133, P-71006015-00252-144, P-71006015-00253-2, P-71006015-00253-3, P-71006015-010255-0 dhe P-71006015-00260-1, të cilat ndodhen në zonën kadastrale në Dush i Vogël, Komuna e Klinës. Kësaj kërkese ia bashkojmë certifikatën e pronës, kopjen e planit dhe kopjen e letërnjoftimit. Mirëpresim shqyrtimin e kërkesës tonë nga ana e juaj. | **Aprovohet** kërkesa që parcelat e përmendura të destinohen si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme.<br><br>**Arsyetim:** Tokat në fjalë u takojnë kategorisë 6 të bonitetit të tokës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 13. | 06-351-13843/25<br>08.05.2025 | **Ahmet Morina** | Kërkesë: Për ndërrim destinimi nga bujqësore në tokë ndërtimore. Unë, Ahmet( Smajl) Morina nga fshati Gllarevë, pas informimit se komuna është duke diskutuar draft-planin zhvillimor komunal të Klinës duke u nisur nga nevoja për të ndërtuar në këtë parcelë me nr.00370-0, kërkoj që parcela ime të kalojë nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Pres që kërkesa ime të merret në shqyrtim nga organi i lartëcekur. Me respekt. | **Refuzohet kerkesa e pales** me arsyetim se toka bujqesore subjekt i kësaj kërkese i takon kategorisë së dytë të bonitetit të tokës.<br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 14. | 06-352-13900/25<br>08.05.2025 | **Ndue Sheraj** | Kërkesë për inkorporimin e varrezave të fshatit Pograxhë në Planin Zhvillimor Komunal të Klinës në fazat e përfundimit – parcelat nr. 00548-1, 00549-0, 00546-1, 00547-0, 00462-1, zona kadastrale Klinafc.<br>Kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të inkorporohen varrezat e fshatit Pograxhë në Planin Zhvillimor Komunal të Klinës, të cilat ndodhen në fazat e përfundimit, për parcelat me nr. 00548-1, 00549-0, 00546-1, 00547-0 dhe 00462-1, zona kadastrale Klinafc. Aktualisht, këto parcela kanë destinim si zonë pyjore.<br>Kërkesa është parashtruar më parë në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe e njëjta skicë është dërguar në kompaninë konsulente UBT më datë 22.10.2024.<br>Varrezat janë të rrethuara me shtylla betoni dhe rrjetë që nga viti 1970 dhe përmbajnë mbi 110 varre. Andaj, shpresojmë që kërkesa jonë të marrë mirëkuptimin e organit të lartpërmendur dhe që, në rastin e aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal, të miratohet si e arsyeshme dhe të inkorporohet edhe në | **Aprovohet kerkesa e palës** për shkak të nevojës së zgjerimit të hapësirës së varrezave. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Hartën Zonale të Komunës së Klinës.<br>Gjithashtu, sipërfaqja e ndarë dhe e bashkangjitur me incizimin gjeodezik të destinohet për varreza. | |
| 15. | 06-351-13877/25<br>08.05.2025 | **Nikollë Mrijaj** | Kërkesë – për futjen në zonën e ndërtimit me plan zhvillimor të parcelës P-71006019-00077-4, zona kadastrale Zllakuqan.<br>Kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë inkorporimin në zonën ndërtimore me plan zhvillimor të parcelës P-71006019-00077-4, zona kadastrale Zllakuqan, e cila aktualisht është me destinim bujqësor.<br>Ju njoftojmë se rreth kësaj parcele ndodhen objekte ndërtimore me destinime të ndryshme dhe është e paqartë se si parcela ka mbetur me destinim bujqësor, kurse ndërtimet në atë zonë kanë filluar që nga vitet e hershme. Edhe sot vazhdojnë të ndërtohen objekte të ndryshme, si shtëpi banimi, objekte afariste etj.<br>Andaj, si pronar i kësaj parcele, shpresoj që kërkesa ime të pranohet nga organi i lartpërmendur dhe që me rastin e miratimit të Planit Zhvillimor Komunal, të aprovohet si e arsyeshme dhe të inkorporohet edhe në Hartën Zonale të Komunës së Klinës, duke i ndryshuar destinimin parcelës time në tokë ndërtimore.<br>Kësaj kërkese i bashkangjis fletën posedues dhe kopjen e planit.<br>Me respekt. | **Aprovohet kerkesa e pales** me arsyetimin se parcela ne fjale eshte e rrethuar me zone ndertimore. |
| 16. | 06-351-13566/25<br>06.05.2025 | **Riton Bytyqi – Ibadete Bytyqi** | Drejtorit të Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit në Klinë<br>Lënda: Kërkesë për ndryshimin e destinacionit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore<br>Nga**:** Riton Ramadan Bytyqi dhe Ibadete Hajdin Bytyqi, nga Klina, Komuna e Klinës<br>Unë, Riton Ramadan Bytyqi dhe Ibadete Hajdin Bytyqi, si pronarë faktikë dhe juridikë të njësisë kadastrale nr. 00801-1, zona kadastrale Dollc, në vendin e quajtur Kumovaçe-Selishte, me sipërfaqe prej 1212 m², me shfrytëzim aktual | **Aprovohet kerkesa e pales** me arsyetimin se parcela në fjalë i takon kategorisë 5 të bonitetit të tokës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Arë e klasit 5, kërkojmë që të na lejohet ndryshimi i destinacionit të parcelës nr. 00801-1, nga tokë bujqësore – Arë e klasit 5 – në tokë ndërtimore.<br><br>Kërkojmë që kjo parcelë, me sipërfaqe prej 1212 m², të shndërrohet në tokë ndërtimore, për të mundësuar ndërtimin e shtëpisë personale për mua dhe familjen time të ngushtë. | |
| 17. | 06-351-12328/25<br>25.04.2025 | **Ardian Deskaj** | LËNDA: Kërkesë për leje ndërtimi me sipërfaqe 400-500 m² në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, njësia kadastrale P-71010027-01648-0.<br>Arsyetimi:Aktualisht në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, në rrugën “Prek Prendi”, ndodhet njësia kadastrale me numër P-71010027-01648-0. Sipas rregullave të Komunës së Klinës dhe Hartës Zonale, për ndërtimin e një shtëpie banimi kërkohen 1000 m² (10 ari).Zyrtarët komunalë kanë deklaruar se këto janë rregullat aktuale të komunës. Megjithatë, kemi dëgjuar se po shqyrtohet mundësia për ndryshimin ose revidimin e këtyre rregullave për dhënien e lejeve ndërtimore.<br>Në këtë zonë ka vetëm shtëpi banimi, dhe një shtëpi mesatare ka sipërfaqe rreth 100 m² (10x10 metra). Sipas rregullave aktuale, nëse shtëpia ka 100 m², atëherë mbeten 900 m² tokë e papërdorur si oborr, që do të thotë se një sipërfaqe e madhe toke bujqësore mbetet e pashfrytëzuar.<br>Gjithashtu, është shumë e vështirë të gjenden 10 ari tokë për ndërtim në këtë zonë, duke e bërë pothuajse të pamundur për banorët të ndërtojnë shtëpi.<br>Prandaj, me këtë kërkesë kërkojmë nga Komuna e Klinës dhe organet përgjegjëse që të ndryshojnë këtë rregull, duke ulur sipërfaqen minimale për lejen e ndërtimit nga 1000 m² në 400 m² (4 ari). Kështu, nëse shtëpia ka 100 m², mbeten edhe 300 m² për oborr, që është një sipërfaqe e mjaftueshme për nevojat e banimit.<br>Ky rregull tashmë aplikohet në shumë qytete të Kosovës dhe në vende të tjera. | Kerkesa refuzohet me arsyetimin se lënda nuk eshte subjekt i PZHK-se. |
| 18. | 06-463-13727/25<br>07.05.2025 | **Artan Rama** | Tema: Kërkesë për ndryshimin e destinacionit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore – Njësia kadastrale 06-463-13727/25<br><br>Unë, Artan Rama, nga fshati Pjetërq i Epërm, Komuna e Klinës, me këtë kërkesë ju drejtohem Drejtorisë suaj për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, me qëllim që të ndryshohet destinacioni i parcelës me numër P-71011027- | Kerkesa e pales aprovohet me arsyetim se parcela është e rrethuar me tokë ndërtimore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 00018-1, zona kadastrale Pjetërq i Ulët, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Kjo parcelë ndodhet përgjatë magistrales Prishtinë-Pejë dhe ka një sipërfaqe prej 35 ari. Parcela është mbushur me zhavor para disa viteve dhe për këtë arsye është e papërshtatshme për përdorim bujqësor. Prandaj, më nevojitet që të ndryshohet destinacioni për ndërtim dhe zhvillim biznesi.<br>Ju lutem të shqyrtoni kërkesën time dhe të më njoftoni për vendimin e marrë. Jam i gatshëm të siguroj çdo dokumentacion shtesë dhe të kryej pagesën e tarifave të nevojshme.<br><br>Me respekt,<br>Artan Rama | |
| 19. | 06-463-14957/25<br><br>20.05.2025 | **Tom Duhani** | Unë, Tom Duhani, me këte kërkesë zyrtare deshiroj te parages per shayrtim mundesine e ndërrimit te destinimit te parcelave bujqesore ne pronesi time, te cilat ndodhen në zonën kadastrale Dolle ne parcelat [00277-0, 00278-0 dhe parcela 00279-0], nga parcela bujgesore ne parcela te pershtatshme pêr ndertim te larte.<br><br>Me këtë rast, ju lutem qe körkesa ime te vendoset ne planin zhvellimor komunal PZHK, dhe të shgyrtohet me prioritet nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapesinor, dhe te iniciohet procesi i ndryshimit tê destinimit sipas procedurave tê parapara ligjore.<br><br>Faleminderit per mirëkuptimin dhe gatishmërinë tuaj per te shgyrtuar ketë kërkesë | Aprovohet me arsyetimin se kto parcela jane përgjatë tranzitit. |
| 20. | 06-352-13275/25<br><br>05.05.2025 | **Luigj Prenaj** | Klinë, më 27.11.2024<br>Lënda: Kërkesë shtesë për zgjerimin e hapësirës së varrezave në Ceravikë<br>Të nderuar,<br>Ju drejtohemi me këtë kërkesë shtesë për rishqyrtim dhe mirëkuptim lidhur me domosdoshmërinë e zgjerimit të hapësirës për varreza në zonën tonë. Siç jeni në | Aprovohet kerkesa e pales per shkak te nevojave te komunitetit per zgjerim te hapesires se varrezave. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | dijeni, parcela ekzistuese e varrezave ka një sipërfaqe prej **18 ari**, e cila tashmë është e pamjaftueshme për nevojat e banorëve. Në këtë drejtim, propozojmë që kësaj parcele t'i shtohet edhe një sipërfaqe prej **13 ari**, e cila është hapësirë publike e pashfrytëzuar. Kërkesa jonë është shumë e arsyeshme dhe urgjente, pasi aktualisht nuk ka më hapësirë të lirë për varrime dhe ekziston rreziku që të detyrohemi të përdorim hapësira jashtë varrezave ekzistuese. Kjo çështje kërkon një zgjidhje të menjëhershme dhe trajtim me ndjeshmëri të lartë njerëzore.Shpresojmë që kjo kërkesë të realizohet, dhe pas aprovimit të saj, synojmë që në bashkëpunim me institucionet dhe komunitetin, të rregullojmë infrastrukturën e asaj pjese, e cila aktualisht është në gjendje të papërshtatshme.Planifikojmë të përfshijmë:Rrethimin e varrezave me mur, ndërtimin e trotuarit, krijimin e hapësirës për parkim, përmirësime të tjera që do t'u lehtësojnë qasjen banorëve dhe respektin ndaj të ndjerëve të tyre. | |
| 21. | 06-463-13942/25<br>08.05.2025 | **Fehmi Berisha** | KËRKESË: Për ndërrimin e destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Unë, Fehmi Berisha nga fshati Volljakë, pasi jam informuar se Komuna e Klinës është duke diskutuar draft-Planin Zhvillimor Komunal, dhe duke u nisur nga nevoja ime për të ndërtuar në parcelën time me nr. 02201-0, që ndodhet në zonën kadastrale Dresnik, paraqes këtë kërkesë që parcela në fjalë të kalojë nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Pres që kërkesa ime te merret në shqyrtim nga organi i lartëcekur. Me respekt. Nr i telit.044-148787 | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda Zonës së Mbrojtur të Asetit |
| 22. | 06-351-13936/25<br>08.05.2025 | **Faruk Gashi** | KËRKESË Nr. 351-13956.Unë, Faruk (Cen) Gashi, me vendbanim në Këpuz dhe me numër personal 1002504622, përmes kësaj shkrese kërkoj nga Komuna e Klinës që të më mundësojë ndryshimin e destinacionit për tokat me numrat kadastralë 00275-4 dhe 00275-1.Parcelat në fjalë aktualisht janë tokë bujqësore, ndërsa kërkoj që ato të kalohen në tokë ndërtimore, me qëllim që të më lejohet ndërtimi në këto parcele.Bashkangjitur kësaj kërkese gjenden certifikata e pronësisë së tokës dhe kopja e planit të parcelave. | **Aprovohet kërkesa e palës** me arsyetimin se parcela në fjalë është brenda kufirit ndërtimor në ZK Kpuz. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 23. | 06-351-13888/25<br>08.05.2025 | **Leotrim Mustafaj** | Nga: Leotrim Mustafaj, Klinë<br>Kërkesë: Për ndryshim destinacioni nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.<br>Unë, Leotrim (Basri) Mustafaj nga Klina, pas informimit se Komuna është duke diskutuar draft-planin zhvillimor komunal të Klinës dhe duke u nisur nga nevoja për tenderim në këto parcela me numrat 00801-4 dhe 00801-5, ZK Dollc kërkoj që parcelat e mia të kalojnë nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.Pres që kërkesa ime të merret në shqyrtim nga organi i lartpërmendur. | Aprovohet kërkesa e palës me arsyetimin se kjo zonë veq ka ndërtime përreth |
| 24. | 06-463-15034/25<br>20.05.2025 | **Lale Grabanica** | Lënda: Kërkesë për ndryshimin e destinacionit të ndërtimit.<br>Pasi që Komuna e Klinës është duke hartuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj të më mundësohet ndryshimi i destinacionit të ndërtimit nga banim individual në banim kolektiv P+6 (shumëbanesor) në parcelat nr. 218-11, 218-13 dhe 218-15, zona kadastrale Klinë, në rrugën Vëllezërit Frashëri.Kjo kërkesë bazohet në faktin se deri në kufirin me këto parcela është i paraparë ndërtimi shumëbanesor. Shpresoj që kërkesa ime të shqyrtohet dhe të miratohet nga ana juaj. | **Kerkesa refuzohet** me arsyetimin se nuk eshte subjekt i PZHK-se. |
| 25. | 06-463-15111/25<br>21.05.2025 | **Idriz Bytyqi** | Jam Idriz (Feriz) Bytyqi, me vendbanim në Arllat dhe numër personal 1010413270. Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkoj nga Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të më mundësohet ndryshimi i destinacionit të tokës, konkretisht për parcelën me numër 02268-8, e cila është pronë e imja dhe është e evidentuar në emrin tim personal. Parcela në fjalë aktualisht është tokë bujqësore, ndërsa kërkoj që ajo të përfshihet në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe në dokumentet relevante të komunës si tokë ndërtimore, me qëllim që të më mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | **Refuzohet kërkesa** me arsyetimin se parcela në fjalë është tokë bujqësore e kategorive I-IV.<br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 26. | 06-463-15107/25<br>21.05.2025 | **Frok Palushaj** | Kërkesë për ndryshimin e destinacionit të parcelave në zonën kadastrale Dresnik.<br>Kërkojmë ndryshimin e destinacionit për parcelat me numrat: 00065-11, 00065-1, 00065-2, 00065-3, 00065-4, 00065-5, 00065-6, dhe 00065-8, që ndodhen në zonën kadastrale Dresnik. Kërkojmë që këto parcela të kalohen në zonë ndërtimore, me qëllim mundësimin e ndërtimit të objekteve për biznes.po ashtu kerkojme edh një parcele tjeter me Nr. 00238-3 dhe 00238-4 ZK Klinë te ridestinohen toke ndertimi. | **Refuzohet kerkesa** me arsyetimin se nuk është subjket i PZHK-së. |
| 27. | 06-463-15109/25<br>21.05.2025 | **Habib Foniqi** | Unë, Habib (Latif) Foniqi, me vendbanim në Dresnik dhe me numër personal 1003455137, nëpërmjet kësaj shkrese kërkoj nga Komuna e Klinës që të më mundësohet ndryshimi i destinacionit për tokën me numër parcelë 00777-13. Parcela në fjalë aktualisht është tokë bujqësore, ndërsa unë kërkoj që ajo të kategorizohet si tokë ndërtimore, me qëllim që të më lejohet ndërtimi në këtë parcelë.<br>Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | **Kërkesa aprovohet** me arsyetimin se kjo parcelë ndodhet ne trasenë e rruges se palnifikuar sipas HZK-së (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. |
| 28. | 06-463-15112/25<br>21.05.2025 | **Benita Bio Produkt** | Nga**:** Benita Bio Produkt Shpk. ID: 811243071. Pronar: Binak Kalludra Komuna e Klinës.<br>Lënda**:** Kërkesë për ndryshim të destinimit të parcelave në zonën kadastrale Dollc Kame, Komuna e Klinës.<br>Unë, si përfaqësues i Benita Bio Produkt Shpk, me vendbanim në Komunën e Klinës, në zonën kadastrale Dollc, posedojmë parcelat me numrat: P-71010022-00458-0, me sipërfaqe 7,034 m², tokë bujqësore, klasë e tretë (arë), P-71010022-00459-0, me sipërfaqe 8,903 m², tokë bujqësore, klasë e tretë (arë).<br>Këto parcela aktualisht janë të kategorizuara si tokë bujqësore, klasë e tretë.<br>Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe nevojat për zhvillim të biznesit dhe ndërtim, kërkojmë që këto parcela të ndryshojnë destinacionin dhe të kalojnë në destinacion për zhvillim biznesi dhe ndërtim. Prandaj, kërkojmë | **Aprovohet kerkesa** pales me arsytetimin qe parcelat pe rreth veq jane me ndertime si dhe parcela ndodhet pergjate trasesë se tranzitit dhe si e tille kjo parcel e ridestinuar ne toke ndertimore ngrit potencialin zhvillimor. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | nga Komuna e Klinës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, që këto parcela të përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal si parcela për ndërtim dhe zhvillim të veprimtarisë së biznesit. | |
| 29. | 06-463-15114/25<br>21.05.2025 | **Frasher Qeku – Fatlum Qeku** | Ne, Frasher (Sami) QEKU dhe Fatlum (Naser) QEKU, pronarë të parcelës me numër P-71010027-02066-1, me sipërfaqe prej 12,280 m², tokë male, klasë e dytë, në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, kërkojmë që kjo parcelë, bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), të ndryshojë destinacionin dhe të kalojë në destinacion për zhvillim biznesi dhe ndërtim, për nevojat e biznesit tonë.<br>Prandaj, kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Klinës që parcela e sipërpërmendur të përfshihet në PZHK si parcelë për ndërtim dhe zhvillim të veprimtarive të biznesit. | **Refuzohet kërkesa** e palës, me arsyetimin së parcela i takon kategorise II të bonitetit të tokës.<br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 30. | 06-463-15117/25<br>21.05.2025 | **Metë Shala** | Nga: Metë (Tahir) Shala, Komuna e Klinës<br>Lënda:Kërkesë për ndryshimin e destinimit të parcelave në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës. Unë, Metë (Tahir) SHALA, pronar i parcelave me numra: P-71010027-02069-1 me sipërfaqe prej 15,951 m², P-71010027-02069-3 me sipërfaqe prej 12,733 m², të cilat janë tokë malore në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, kërkoj që këto parcele, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), të ndryshojnë destinacionin dhe të kalojnë në destinacion për zhvillim biznesi dhe ndërtim, për nevojat e biznesit tim. Prandaj, kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Klinës që këto parcele të përfshihen në PZHK si parcele për ndërtim dhe zhvillim të veprimtarive biznesore. | **Refuzohet kerkesa** për ndërrim të destinimit të parcelave në fjalë, me arsyetimin se parcelat gjenden ne zone pyjore (Mal i Klasës 4). Vendimi për refuzim bazohet në **Ligjin Nr. 02/L-26 Për Tokën Bujqësore**. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 31. | 06-463-15115/25<br>21.05.2025 | **Binak Kalludra** | Unë, Binak KALLUDRA, pronar i parcelave me numrat dhe sipërfaqet si vijon: P-71010022-00287-0 me sipërfaqe prej 4,886 m² (tokë bujqësore – livadhe, klasë e dytë), P-71010022-00299-0 me sipërfaqe prej 1,001 m² (tokë bujqësore – arë, klasë e dytë), P-71010027-02067-1 me sipërfaqe prej 11,820 m² (tokë pyjore – mal, klasë e dytë), kërkoj që këto parcela, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), të ndryshojnë destinacionin dhe të kalojnë në destinacion për zhvillim biznesi dhe ndërtim, për nevojat e biznesit tim. Prandaj, kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Klinës që parcelat e lartcekura të përfshihen në PZHK si parcela për ndërtim dhe zhvillim të veprimtarive biznesore. | **Kërkesa aprovohet pjesërisht** dhe në atë mënyrë që kërkesa për ndërrim të destinimit të parcelave P-71010022-00287-0 dhe P-71010022-00299-0 (ZK Dollc) në tokë ndërtimore aprovohet me arsyetimin se parcelat në fjalë gjenden në afërsi të parcelave të ndërtuara dhe me destinim Tokë Ndërtimore. Ndërsa **refuzohet kërkesa** për ndërrim të destinimit të parcelës P-71010027-02067-1 (ZK Dresnik) me arsyetimin se parcelat gjenden ne zone pyjore (Mal i Klasës 2 Vendimi për refuzim bazohet në **Ligjin Nr. 02/L-26 Për Tokën Bujqësore**. |
| 32. | 06-463-15120/25<br>21.05.2025 | **Avdyl Pantina** | Unë, Avdyl Pantina, pronar i parcelave me numrat dhe sipërfaqet si më poshtë: P-71010027-02113-2 me sipërfaqe prej 2,040 m², P-71010027-02114-2 me sipërfaqe prej 1,116 m², të cilat janë toka malore, kërkoj që këto parcela, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), të ndryshojnë destinacionin dhe të kalojnë në destinacion për zhvillim biznesi dhe ndërtim, për nevojat e biznesit | **Refuzohet kerkesa** për ndërrim të destinimit të parcelave në fjalë, me rekomandim të MMPHI-së dhe MBPZHR dhe me |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | tim.<br>Prandaj, kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Klinës që parcelat e sipërpërmendura të përfshihen në PZHK si parcela për ndërtim dhe zhvillim të veprimtarive biznesore. Faleminderit për mirëkuptim! | arsyetimin se parcelat gjenden ne zone pyjore (Mal i Klasës 4). Vendimi për refuzim bazohet në **Ligjin Nr. 02/L-26 Për Tokën Bujqësore**. |
| 33. | 06-463-15121/25<br>21.05.2025 | **Fisnik Qeku – Sami Qeku** | Ne, Fisnik EKU dhe Sami QEKU, pronarë të parcelës me numër P-71010027-02066-2, me sipërfaqe prej 24,968 m², tokë malore e klasës së dytë në zonën kadastrale Dresnik, kërkojmë që parcela jonë, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), të ndryshojë destinacionin dhe të kalojë në destinacion për zhvillim biznesi dhe ndërtim, për nevojat e biznesit.<br>Prandaj, kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Klinës që parcela e sipërpërmendur të përfshihet në PZHK si parcelë për ndërtim dhe zhvillim të veprimtarive biznesore.<br>Faleminderit për shqyrtimin dhe mirëkuptimin. | **Aprovohet kerkesa** e pales me arsyetimin keto parcela ndodhen per gjate rruges Peje- Prishtine si te tilla jane parcela pyjore shkembore dhe ridestinimi i tyre ne ato ndertimore eshte i pershtatshem me hapesirat ku ndothet parcela. |
| 34. | 06-463-15150/250<br>21.05.2025 | **Don Jeton Thaqi** | Nga: Famullia e Klinës.<br>Lënda:Kërkesë për ndryshimin e destinimit të parcelave nga zonë bujqësore/rekreacion në zonë ndërtimore të lartë/industriale dhe përfshirjen në PZHK<br>(Parcela nr. 00218-1-32-0, 00218-1, 00218-2, ZK Klinë)<br>I nderuar Drejtor i DUMM,<br>Me anë të kësaj letre, Famullia e Klinës paraqet kërkesë zyrtare për ndryshimin e destinimit të parcelave në pronësi të saj, të cilat aktualisht janë të kategorizuara si zonë bujqësore dhe rekreacion.<br>Kërkojmë që këto parcela të ri-kategorizohen në zonë ndërtimore të | **Kërkesa pranohet pjesërisht** me arsyetimin se destinimi i parcelave në fjalë në draft-PZHK Klinë 2025-2033 përfshinë edhe Shfrytëzimin e Përzier dhe Industrinë e Prodhimeve të lehta.<br>Ndërsa **refuzohet kërkesa** për ndërrim të destinimit në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | lartë/industriale, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës dhe ekonomisë lokale.<br>Është shumë e rëndësishme që ky ndryshim destinacioni të përfshihet në Planin Zhvillimor Komunal të Klinës (PZHK), në mënyrë që të lehtësohet planifikimi dhe zhvillimi afatgjatë i këtyre parcelave në përputhje me objektivat strategjike të komunës.<br>Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë dhe të na informoni për hapat e nevojshëm që duhet të ndërmarrim për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe procedurale për miratimin e këtij ndryshimi. | zonë ndërtimore të lartë me arsyetimin se kjo kërkesë është jashtë subjektit të PZHK-së. |
| 35. | 04-463-15151/25<br>21.05.2025 | **Anton Kuqi** | Kërkesë për ndryshim të destinimit të parcelave 00381-0, 00382-0 dhe 00383-0, ZK Krushevë.<br>Kërkoj nga Komuna e Klinës, përkatësisht nga Drejtoria e Urbanizmit, Mbrojtjes dhe Mjedisit, që në kuadër të hartimit të planit për zhvillim komunal (PZHK), të merren parasysh kërkesën time për ndërrimin e destinimit të parcelave në ZK Krushevë me numër të parcelave 00381-0, 00382-0 dhe 00383-0, ta ndërroj nga tokë bujqësore klasa 5 në tokë për ndërtim të lartë.<br>Shpresoj që kërkesa ime të hasë në mirëkuptimin tuaj. | **Refuzohet kërkesa** me arsyetsimin se parcelat në fjalë gjendent në zonën e destinuar si Tokë Bujqësore dhe nuk ka ndërtime përreth.<br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 36. | 06-463-15186/25 | **Fatos Sylaj** | Lënda: Kërkesë për futjen në zonën ndërtimore me Plan Zhvillimor të parcelës Nr. P-71010027-00254-5, zona kadastrale Dresnik.<br>Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit<br>Kërkojmë që parcela me Nr. P-71010027-00254-5, në zonën kadastrale Dresnik, të përfshihet në zonën ndërtimore me Planin Zhvillimor Komunal | **Aprovohet kërkesa** me arsyetimin se parcela në fjalë është e përfshirë brenda |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | (PZHK). Ju informojmë se këtë parcelë e kam blerë që në vitin 1982 dhe ajo është e ndarë në disa parcela të vogla. Parcela në fjalë ndodhet në pjesën ku ka ndërtim shtëpish banimi në anët përreth, dhe në këtë zonë ka lagje të tëra të ndërtuara me shtëpi banimi. Vetëm pjesa ku unë po kërkoj leje ndërtimi nuk është e përfshirë në zonën ndërtimore, gjë që është shumë e paqartë pasi ndërtimet në atë zonë kanë filluar që prej viteve të hershme. Ndërkohë, shtëpitë e ndërtuara më herët janë në proces legalizimi.<br>Andaj, shpresojmë që kjo kërkesë të marrë mirëkuptimin tuaj dhe që me rastin e aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal, parcela të përfshihet në hartën zonale si zonë ndërtimore dhe të lejohet ndërtimi në të. | kufirit ndërtimor të ZK Dresnik. |
| 37. | 06-352-15004/25<br>20.05.2025 | **Rasim Maliqaj** | Ne, banorët e fshatrave Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë të Komunës së Klinës, ju njoftojmë se aktualisht nuk kemi sipërfaqe të tokës ku të mund të vendosim ose të varrosim personat që ndërruan jetë në komunitetin tonë. Për këtë arsye, kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Mjedisit, konkretisht Komisioni për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), që të bëjë përfshirjen e parcelave kadastrale me numrat dhe sipërfaqet:<br>P-71010034-00661-0, sipërfaqe 1,757 m²; P-71010034-00659-0, sipërfaqe 13,759 m²; P-71010034-00658-0, sipërfaqe 5,742 m²; P-71010034-00657-0, sipërfaqe 8,003 m². Të gjitha këto parcela ndodhen në Zonën Kadastrale Gllarevë dhe janë në pronësi të Komunës së Klinës.<br>Ne si banorë kemi bërë kërkesa të ngjashme në të kaluarën, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje lidhur me këtë çështje të rëndësishme. Kërkesat e fundit janë adresuar edhe në Kuvendin e Komunës (Komiteti për Politikë dhe Financa), ku pas shqyrtimit unanimisht shefat e grupeve të Asamblesë Komunale janë pajtuar që banorëve të këtyre fshatrave t’u jepet zgjidhje. Megjithatë, është theksuar se kërkesa duhet të adresohen te Komisioni për PZHK, për përfshirjen në hartat zonale të reja dhe përcaktimin e destinacionit të tokës për shfrytëzim si varreza. Këtë mund ta verifikoni edhe në procesverbalin e seancës së Kuvendit Komunal | **Aprovohet kerkesa** e komunitetit për destinim të parcelave në fjalë si Hapësirë për varreza. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | të Klinës. Në bashkëngjitje të kësaj kërkese gjeni: Listën e nënshkrimeve të banorëve të fshatrave Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë, pëlqimin e institucioneve fetare Islame, fletët poseduese të parcelave të përmendura, ortofotot e parcelave, dokumente të tjera relevante që mbështesin këtë kërkesë. Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe presim veprime të shpejta për zgjidhjen e kësaj çështjeje shumë të rëndësishme për komunitetin tonë. | |
| 38. | 06-463-14955/25<br>20.05.2025 | **Famullia e Klinës** | Lënda: Kërkesë për ndryshimin e destinimit të parcelave nga zonë bujqësore/rekreacion në zonë ndërtimore të lartë/industriale dhe përfshirjen në PZHK *(Parcela 00218-1-32-0, 00218-1, 00218-2, ZK Klinë).*<br>I nderuar Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Mbrojtjes dhe Mjedisit (DUMM),<br>Me anë të kësaj letre, Famullia e Klinës paraqet një kërkesë zyrtare për ndryshimin e destinimit të parcelave në pronësi të Famullisë, të cilat aktualisht janë të kategorizuara si zonë bujqësore dhe rekreacion.<br>Ne kërkojmë që këto parcela të ri-kategorizohen në zonë ndërtimore/industriale, për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe ekonomisë lokale.<br>Është e rëndësishme për ne që ky ndryshim i destinimit të përfshihet në Planin Zhvillimor të Komunës së Klinës (PZHK), në mënyrë që të lehtësohet planifikimi dhe zhvillimi afatgjatë i këtyre parcelave në përputhje me objektivat strategjike të komunës.<br>Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë dhe të na informoni për hapat e nevojshëm që duhet të ndërmarrim për të përmbushur kërkesat ligjore dhe procedurale për miratimin e këtij ndryshimi.Me respekt,<br>Don Jeton Thaqi, tel: 049-238-049 | Kërkesa është e njëjtë me kërkësen nr. 34 (06-463-15150/25 – Don Jeton Thaci) |
| 39. | 06-463-14947/25<br>20.05.2025 | **Kreshnik Racaj** | Duke u bazuar në fazën e debatit publik dhe mundësinë e dhënë për koment lidhur me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) të Komunës së Klinës, unë, Kreshnik Racaj, parashtroj kërkesën (propozimin) time ndaj Drejtorisë së Urbanizmit, Mbrojtjes dhe Mjedisit (DUMM) në Komunën e Klinës, që të bëjë | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ndryshimin e destinimit të parcelës me numër P-71010027-01232-0, në Zonën Kadastrale Dresnik, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. | fjalë gjendet brenda Zonës së Mbrojtur të Asetit |
| 40. | 06-463-14903/25<br>20.05.2025 | **Ilir Tirana** | Lënda: Kërkesë për futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor parcelën Nr. 01106-3, zona kadastrale Dresnik<br>Kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor parcelën me Nr. 01106-3, zona kadastrale në Dresnik.<br>Ju informoj se këtë parcelë e kam blerë në vitin 2018, pasi që është e ndarë në parcela dhe gjendet në pjesën ku ka shtëpi ndërtimi në të dyja anët, ka lagje të tëra të ndërtuara me shtëpi banimi. Vetëm pjesa ku unë po kërkoj të futet si zonë ndërtimore është shumë e pashpjegueshme se si ka mbetur në këtë mënyrë, pasi që ndërtimi në atë zonë ka filluar që nga vitet e herëshme, ku vazhdimisht ndërtohen shtëpi banimi, kurse ato të ndërtuara më herët janë në procedurë të legalizimit.<br>Andaj shpresojmë që kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim nga Drejtoria e Urbanizmit, që me rastin e aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të aprovohet si e arsyeshme dhe të inkorporohet në hartën zonale dhe në atë zonë të lejohet ndërtimi. | **Aprovohet kërkesa** e palës me arsyetimin se kjo parcelë gjendet në afërsi të kufirit ndërtimor të ZK Dresnik. |
| 41. | 06-463-14901/25<br>20.05.2025 | **Haxhi Ibishi** | Lënda: Kërkesë për futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor parcelën Nr. 01106-5, zona kadastrale Dresnik<br>Kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor parcelën me Nr. 01106-5, zona kadastrale në Dresnik.<br>Ju informoj se këtë parcelë e kam blerë në vitin 2018, pasi që është e ndarë në parcela dhe gjendet në pjesën ku ka shtëpi ndërtimi në të dyja anët, ka lagje të tëra të ndërtuara me shtëpi banimi. Vetëm pjesa ku unë po kërkoj të futet si zonë ndërtimore është shumë e pashpjegueshme se si ka mbetur në këtë mënyrë, pasi që ndërtimi në atë zonë ka filluar që nga vitet e hershme, ku vazhdimisht | **Aprovohet kërkesa** e palës me arsyetimin se kjo parcelë gjendet në afërsi të kufirit ndërtimor të ZK Dresnik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ndërtohen shtëpi banimi, kurse ato të ndërtuara më herët janë në procedurë të legalizimit.<br>Andaj shpresojmë që kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim nga Drejtoria e Urbanizmit, që me rastin e aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të aprovohet si e arsyeshme dhe të inkorporohet në hartën zonale dhe në atë zonë të lejohet ndërtimi. | |
| 42. | 06-463-14916/25<br>20.05.2025 | **Valon Racaj** | Duke u bazuar në fazën e debatit publik dhe mundësinë e dhënë për komentin lidhur me Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, unë, Valon Racaj, parashtroj kërkesë Drejtorisë së Urbanizmit, Mbrojtjes dhe Mjedisit në Komunën e Klinës që të bëjë ndryshimin e parcelës me nr. P-71010027-00293-12, Zona Kadastrale Dresnik, nga toka bujqësore në atë ndërtimore. | **Refuzohet kërkesa** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda zonës së destinuar për Tokë Bujqësore si dhe nuk ka ndërtime në afërsi të saj.<br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 43. | 06-463-14905/25<br>20.05.2025 | **Arben Tirana** | Kerkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor parcelën me Nr. 01106-4, zona kadastrale Dresnik. Ju informoj se këtë parcelë e kam blerë në vitin 2018, pasi që është e ndarë në parcela dhe gjendet në pjesën ku ka shtëpi ndërtimi në të dyja anët. Ka lagje të tëra të ndërtuara me shtëpi banimi, vetëm pjesa ku unë po kërkoj të futet si zonë ndërtimore është shumë e pazbatuar, pasi që ndërtimi në atë zonë ka filluar që nga vitet e hershme, ku vazhdimisht ndërtohen shtëpi banimi, kurse ato të ndërtuara më herët janë në procedurë të legalizimit. Andaj shpresojmë që | **Aprovohet kërkesa** e palës me arsyetimin se kjo parcelë gjendet në afërsi të kufirit ndërtimor të ZK Dresnik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | kërkesa jonë të hasë në mirëkuptim nga Drejtoria e Urbanizmit, që me rastin e aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të aprovohet si e arsyeshme dhe të inkorporohet në hartën zonale dhe në atë zonë të lejohet ndërtimi. | |
| 44. | 06-463-14874/25<br>19.05.2025 | **Sheremet Bajraktaraj** | KËRKESË PËR NDRYSHIMIN E DESTINIMIT TË PALUAJTSHMËRISË - e cila gjendet në Zonën Kadastrale Dresnik, Komuna Kadastrale Klinë.<br>Unë posedoj paluajtshmëri në dy zona kadastrale të Zonës Kadastrale Dresnik, me numrat: 01262-3 dhe 01263-3 ZK Dresnik, në vendin e quajtur Podvodnice Divijaka. Parcela e parë ka sipërfaqe prej 487 m², kurse parcela e dytë 513 m².<br>Paluajshmëritë në fjalë figuron në emrin tim, por me nga gjysma (½), bashkëpronare me znj. Fahrije Bajraktaraj.<br>Siç dihet, paluajshmëritë në fjalë i takojnë zonës bujqësore, ku nuk lejohet ndërtimi. Ne po kërkojmë që paluajshmëria në fjalë të legalizohet dhe të ndryshohet destinimi nga zona bujqësore në zonë ndërtimore, për arsye se në të ardhmen e afërt planifikojmë të ndërtojmë shtëpi në këto paluajshmëri. | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda kufijëve të Zonës së Mbrojtur të Asetit. |
| 45. | 06-351-14880/25<br>19.05.2025 | **Dina Godanci** | Lënda: Kërkesë për vendosjen e parkut solar në fshatrat Nagllavë dhe Krushevë në dokumentet e planifikimit hapësinor.<br>I nderuar Dr. Zenun Elezaj,<br><br>Unë, Dina Godanci, përfaqësuese e biznesit SAG DRINI SH.P.K me numër unik identifikues 811368423, ju drejtohem me këtë kërkesë për përfshirjen e pronës së biznesit në Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës. Qëllimi im është zhvillimi, financimi, ndërtimi dhe operimi i impianteve fotovoltaike — parqeve solare — në Zonën Kadastrale të fshatrave Nagllavë dhe Krushevë, Komuna e Klinës.<br>Parcelat që janë pronë e biznesit tim dhe për të cilat kërkoj përfshirjen në planifikimin hapësinor janë:<br>P-71011062-00050-22, P-71011062-00050-28, P-71011062-00050-29, P-71011062-00050-30, P-71011062-00050-32, P-71011062-00050-34, P- | **Arovohet kërkesa pjesërisht.**<br><br>Parcela me nr.00371-69 ZK Krushevë aprovohet të destinohet si Tokë Bujqësore me Shfrytëzim të Përkohshëm për Energji të Ripërtërishme, me arsyetimin se toka i katon kategorisë V të bonitetit të tokës.<br><br>Ndërsa refuzohet kërkesa për të gjitha parcelat tjera subjekt i kësaj kërkese, me arsyesimin se i takojnë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | 71011062-00050-43, P-71011049-00371-69, P-71011049-00371-71, P-71011062-00050-11, dhe P-71011062-00050-12. | kategorive I-IV të bonitetit të tokës.<br><br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |
| 46. | 06-463-14792/25<br><br>19.05.2025 | **Nusret Selmani** | Unë, Nusret Selmani, pronar i ngastrës kadastrale numër 660 të Zonës Kadastrale Klinë, ju drejtohem me këtë kërkesë.<br>Për shumë vite nuk kam pasur të drejtën e ndërtimit të shtëpisë individuale në pronën time, pasi në atë zonë është planifikuar ndërtimi me etazhitet të lartë.<br>Duke mos pasur interes të jetoj në ndërtime të larta, kërkoj që gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të largohet etazhiteti i lartë për pjesën time dhe të lejohet ndërtimi i banesës individuale afariste.<br>Gjithashtu, kërkoj që gjatë procesit të hartimit të dokumenteve të rregullohet vija e ndërtimit dhe vija rregulluese në mënyrë të përshtatshme për ndërtim me etazhitet maksimal B+P+3K.<br>Qëllimi im nuk është të pengoj investimet e ndërtuesve të tjerë, por të investoj në pronën time me shtëpi individuale afariste me etazhitet maksimal B+P+3K.<br>Shpresoj që kërkesa ime të marrë mirëkuptim dhe vlerësim pozitiv. | **Kërkesa refuzohet** me arsyetimin se nuk është subjekt i PZHK-së. |
| 47. | 0-463-14775/25<br><br>19.05.2025 | **Benita Fruits shpk** | Lënda: Kërkesë për shqyrtim dhe ndryshim të destinimit të parcelës nr. 00791-21, Zona Kadastrale Jashanicë, gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të ri<br>I nderuar Drejtor, Duke u bazuar në mundësinë e ofruar për komente dhe propozime në kuadër të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së | **Kerkesa e pales aprovohet pjesërisht** dhe në atë mënyrë që parcela mund të shfrytëzohet vetëm pjesërisht për qëllimet e |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Klinës, kompania Benita Fruits Sh.p.k., e përfaqësuar nga pronari z. Hesen Kalludra, me nr. identifikimi 1233609982, paraqet këtë kërkesë për ndryshimin e destinimit të parcelës me numër 00791-21, e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Jashanicë.<br>Aktualisht, kjo parcelë përbëhet nga dy destinime të ndryshme:Një pjesë e saj është e destinuar për transport ajror, për shkak se aty ndodhet një aeroport i vogël joaktiv, i cili në të kaluarën ka qenë planifikuar për funksione ajrore.Pjesa tjetër është zonë bujqësore, çka kufizon mundësinë për zhvillim të integruar dhe funksional të të gjithë territorit të parcelës.<br>Kompania Benita Fruits Sh.p.k. propozon që e gjithë parcela të kategorizohet si “zonë ndërtimore”, me qëllim që në të ardhmen të mund të planifikohet zgjerimi i kapaciteteve të aeroportit dhe ndërtimi i objekteve përcjellëse të domosdoshme për këtë destinim.<br>Në këtë parcelë planifikohet të ndërtohen: Hangarë për aeroplanë dhe mjete të transportit ajror, objekte administrative dhe operacionale. | kërkuara dhe brenda kufijëve të përcaktuar me Hartën e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës. Kjo e fundit është bazuar në Hartën Zonale në fuqi. |
| 48. | 06-463-14538/25<br>15.05.2025 | **Metë Krasniqi** | Kërkesë për ndryshimin e destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore për parcelën P-71010027-01120-0 me sipërfaqe 10,729 m².<br>I nderuar Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,<br>me anë të kësaj kërkese ju lutem të bëni ndryshimin e destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore për parcelën me numër P-71010027-01120-0, me sipërfaqe 10,729 m². Në bashkëngjitje i kam dorëzuar fletën poseduese, kopjen e planit të parcelës dhe kopjen e letërnjoftimit. Ju lutem që ta shqyrtoni sa më parë këtë kërkesë dhe të filloni procedurat për ndryshimin e destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore. | **Kerkesa aprovohet pjeserisht** dhe ne ate menyre qe ne pjesen e parceles e cila nuk hynë brenda kufijëve të Zonës së Mbrojtur të Asesit lejohet ridestinimi.<br>Ndersa pjesa e parceles e cila hyn brenda kufijeve të Zonës së Mbrojtur të Asetit nuk lejohet ndërrtimi i destimit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 49. | 06-463-14587/25<br>16.05.2025 | **Hetem Desku** | Lënda: Kërkesë për ndryshim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.<br>Unë, Hetem (Xhevat) Desku nga Klina, pasi jam informuar se Komuna është duke diskutuar Draft-Planin Zhvillimor Komunal të Klinës dhe duke u nisur nga nevoja për ndërtim në parcelën time me nr. 02289-2, kërkoj që parcela ime të ndryshojë destinimin nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Pres që kërkesa ime të merret në shqyrtim nga organi kompetent. Me respekt. | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda kufijëve të Zonës së Mbrojtur të Asetit. |
| 50. | 06-463-14658/25<br>16.05.2025 | **Zef Duhanaj** | Lënda: Kërkesë për vendosjen e parkut solar në Radulloc në dokumentet e planifikimit hapësinor. I nderuar Dr. Zenun Elezaj,<br>Unë, Zef Duhanaj, pronar i pronës dhe banues në fshatin Zllakugan, Komuna e Klinës, ju drejtohem me këtë kërkesë. Qëllimi im kryesor është zhvillimi, financimi, ndërtimi dhe operimi i impianteve fotovoltaike – parqe solare – përfshirë edhe parkun solar në Zonën Kadastrale në Radulloc, Komuna e Klinës. Kërkoj nga ky organ që katër zonat kadastrale me numrat: P-71006019-00159-4; P-71006024-00082-65 të përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe në hartat zonale në vazhdim. Kërkesës ia bashkangjis fletën posedues dhe kopjen e planit, si dhe dokumentin tim të identifikimit.<br>Presim shqyrtimin e kësaj kërkese nga ana juaj dhe nga Komuna e Klinës. | **Aprovohet kërkesa e palës** me arsyetimin se parcela në fjalë i takon kategorise V të bonitetit të tokës. |
| 51. | 06-463-14497/25<br>15.05.2025 | **Vilson Mihill Gjoni** | Unë, Vilson Mihill Gjoni, pronar i parcelës me numër P-71010027-01862-3, e cila ndodhet përgjatë rrugës kryesore Klinë-Zajm, ju drejtohem me këtë kërkesë për shqyrtimin dhe mundësinë e ndryshimit të destinimit të kësaj parcele për ndërtim. Parcela në fjalë është e pozicionuar menjëherë skaj rrugës kryesore dhe ndodhet përballë parcelave të tjera, të cilat tashmë janë të destinuara për ndërtim.Kërkoj që edhe prona ime të trajtohet në mënyrë të barabartë me parcelat përreth dhe t'i lejohet destinimi për ndërtim, duke qenë se është në të njëjtën vijë dhe nuk ka ndonjë pengesë funksionale apo ligjore për zhvillimin e saj. Ju lutem që kërkesa ime të merret në konsideratë dhe të mundësohet | **Refuzohet kërkesa** me arsyetimin se parcela gjendet brenda zonës së destinuar për Tokë Bujqësore si dhe nuk ka ndërtim përreth. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | rregullimi i destinimit të parcelës për ndërtim, në përputhje me zhvillimet urbanistike të zonës. | |
| 52. | 06-463-14502/25<br>15.05.2025 | **KS Group SH.P.K** | Kërkesë për shqyrtimin dhe ndryshimin e destinimit të disa parcelave në Zonën Kadastrale Zajm gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të ri të Komunës së Klinës.<br>Të nderuar, duke u bazuar në fazën e debatit publik dhe mundësinë e dhënë për komentim dhe propozime lidhur me Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, ne, KS Group Sh.p.k., të përfaqësuar nga pronarët z. Sokol Kryeziu dhe z. Kushtrim Kryeziu, paraqesim këtë kërkesë për ndryshimin e destinimit të tri parcelave në pronësi të kompanisë sonë, të cilat ndodhen në: Zona Kadastrale: Zajm, Numrat e parcelave: 00435-0, 00220-1, dhe 00221-8<br>Aktualisht, këto parcela janë të kategorizuara si:<br>• Zona ZSHP4 (zonë me shfrytëzim të përzier banimi e komerciale me intensitet të ulët), • Zonë për banim, dhe • Zonë bujqësore. | **Kerkesa aprovohet pjeserisht**.<br>Aprovohet kerkesa për ridestinim të parcelës nr:00221-8 nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.<br>Ndërsa kërkesat lidhur me<br>parcelat me nr. 00435-0 dhe 00220-1 nuk jane subjekt trajtimi i PZHK-së. |
| 53. | 06-463-14406/25<br>14.05.2025 | **Xhevahire Kloppner** | KËRKESË / URGJENCË<br>Duke ju drejtuar titullit të lartpërmendur, kërkojmë nga Komuna - PZHK re-destinimin e parcelës me numër 00092-1, e cila shtrihet në fshatin Pjetërq i Epërm, nga tokë punuese në ndërtimore-biznes.Familja e Immer (Ramë) Miftari jeton dhe punon që nga vitet ’60 në Gjermani. I njëjti ka lënë pas gjashtë fëmijë, dhe prona është bartur si më poshtë: Xhevahire (Immer) Klöppner,Sanije (Immer) Hajrizi, Zenun (Immer) Miftari, Kymete (Immer) Stiebritz Miftari, Fadil (Immer) Miftari,Fatmir (Immer) Miftari. Numri i parcelës: 00092-1 ZK-Klinë – Pjetërq i Epërm | **Aprovohet kerkesa** e pales me arsyetimin se parcelat në fjalë gjenden në afërsi të tokës ndërtimore. |
| 54. | 06-463-14323/25<br>14.05.2025 | **Valdet Manaj** | KËRKESË<br>Jam Valdet (Sefer) Manaj, me numër personal 1174170033, dhe Hirija (Sadik) Manaj, me numër personal 1172885213, me vendbanim në Klinë, rruga "Hasan Prishtina". Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë nga Komuna e Klinës që të na | **Kërkesa aprovohet** me arsyetimin se kjo parcelë ndodhet ne trasenë e rruges se palnifikuar sipas HZK-së |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | mundësojë ndryshimin e destinimit për tokën me numër 00777-66, në zonën kadastrale Dollc. Parcela në fjalë momentalisht është tokë bujqësore, ndërsa kërkojmë që të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të na mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. |
| 55. | 06-463-14318/25<br>14.05.2025 | **Rexhep Manaj** | KËRKESË<br>Jam Rexhep (Sefer) Manaj, me numër personal 1003503905, dhe Sevdije (Bajram) Manaj, me numër personal 1003503891, me vendbanim në Prishtinë. Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë nga Komuna e Klinës që të na mundësojë ndryshimin e destinimit për tokën me numër 00777-3, në zonën kadastrale Dollc. Parcela në fjalë momentalisht është tokë bujqësore, ndërsa kërkojmë që të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të na mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | **Kërkesa aprovohet** me arsyetimin se kjo parcelë ndodhet ne trasenë e rruges se palnifikuar sipas HZK-së (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. |
| 56. | 06-463-14329/25<br>14.05.2025 | **Bedri Manaj** | KËRKESË<br>Jam Bedri (Sefer) Manaj, me numër personal 1013399553, dhe Fatime (Haxhi) Manaj, me numër personal 1013399545, me vendbanim në Klinë, rruga "Hasan Prishtina". Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë nga Komuna e Klinës që të na mundësojë ndryshimin e destinimit për tokën me numër 00777-65, në zonën kadastrale Dollc.<br>Parcela në fjalë momentalisht është tokë bujqësore, ndërsa kërkojmë që të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të na mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | **Kërkesa aprovohet** me arsyetimin se kjo parcelë ndodhet ne trasenë e rruges se palnifikuar sipas HZK-së (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. |
| 57. | 06-463-14344/25<br>14.05.2025 | **Petrit Berisha** | Jam Petrit (Shaban) Berisha, me numër personal 1171365291, me vendbanim në Klinë.Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkoj nga Komuna e Klinës që të më mundësojë ndryshimin e destinimit për tokat me numër 00834-1, 00843-2, 00844-1 dhe 00834-2, në Zonën Kadastrale Klinafc.Parcelat në fjalë | **Kerkesa aprovohet pjeserisht** dhe në atë mënrë që parcelat me numer 00834-1 dhe 00834-3 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | momentalisht janë tokë bujqësore, ndërsa kërkoj që të bëhen tokë ndërtimore, me qëllim që të më mundësohet ndërtimi në këto parcela.Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | aprovohen t'u ndërrohet destinimi nga Toka Bujqësore në Tokë Ndërtimore, ndërsa **refuzohet kërkesa** që parcelave me nr. 00843-2 dhe 00844-1 t'u ndërrohet destinimi, pasiqë parcelat në fjalë preken nga procesi i shpronësimit për rrugën traznit. |
| 58. | 06-463-14357/25<br>14.05.2025 | **Naim Berisha – Vezire Berisha** | LËNDA: KËRKESË PËR NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT NGA TOKË BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE<br>Nga: Naim Ramo Berisha dhe Vezire Ilaz Berisha, nga Rruga Hasan Prishtina nr. 14, Klinë. Unë, Naim Berisha, dhe Vezire Berisha, si pronarë faktikë dhe juridikë të njësive kadastrale nr. 00777-27 Z.K. Dollc, në vendin e quajtur Kunovaçe-Rijeva, me sipërfaqe prej 910m², aktualisht të shfrytëzuara si Arë e Klasit 4, kërkojmë që të na lejohet ndryshimi i kulturës për parcelën nr. 00777-27 Z.K. Dollc, nga tokë bujqësore (Arë e Klasit 4) në tokë ndërtimore.<br>Kërkojmë që të na mundësohet dhe të na lejohet ndryshimi i kulturës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore për: Parcelën nr. 00777-27 Z.K. Dollc, me sipërfaqe prej 910m²,Të na lejohet si tokë ndërtimore, pasi dëshiroj të ndërtoj shtëpi në këtë parcelë për mua dhe familjen time të ngushtë. | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda Zonës së Mbrojtur të Asetit |
| 59. | 06-463-14347/25<br>14.05.2025 | **Petrit Berisha-Adelina Ajdini** | KËRKESË<br>Jam Petrit (Shaban) Berisha, me numër personal 1171365291, dhe Adelina (Shaban) Ajdini, me numër personal 1230182309, me vendbanim në Klinë. Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë nga Komuna e Klinës që të na mundësojë ndryshimin e destinimit për tokën me numër 02222-0, në Zonën Kadastrale | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda Zonës së Mbrojtur të Asetit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Dresnik. Parcela në fjalë momentalisht është tokë bujqësore, por njëkohësisht ndodhet edhe brenda perimetrit të tokës së Zonës së Mbrojtur (me vijë të kaltër). Kërkojmë që të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të na mundësohet ndërtimi në parcelë dhe të largohet nga aseti i mbrojtur. Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | |
| 60. | 06-463-14167/25<br>13.05.2025 | **Jetmir Krasniqi** | KËRKESË<br>Unë, Jetmir Tahit Krasniqi, kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm që të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të destinimit të parcelave me numër 100-2 dhe 100-4, ZK Qupevë të cilat aktualisht janë të kategorizuara si zonë pyjore, për t'u shndërruar në zonë ndërtimore. Qëllimi i këtij ndryshimi është zhvillimi i pronës dhe ndërtimi sipas planeve urbanistike të komunës.<br>Ju lutem që kërkesa të trajtohet sipas procedurave përkatëse. | **Aprovohet kerkesa e pales** me arsyetimin se keto parcela janë me dalje ne rrugen kryesore Kline - Gjakove gje e cila rrit potecialin zhvillimor |
| 61. | 06-463-13964/25<br>08.05.2025 | **Tomë Zeqiri** | KËRKESË<br>Nga: Tomë Nikollë Zeqiri, nga Fshati Deiq, Komuna e Klinës.<br>Unë, Tomë Zeqiri, si pronar faktik dhe juridik i njësive kadastrale nr. 01862-1 Z.K. Dresnik, në vendin e quajtur Fushat e Klinës, me sipërfaqe prej 2520m², aktualisht të shfrytëzuara si Arë e Klasit 2, kërkoj që të më lejohet ndryshimi i kulturës për parcelën nr. 01862-1 Z.K. Dresnik, nga tokë bujqësore (Arë e Klasit 2) në tokë ndërtimore.<br>Kërkoj që të më mundësohet dhe të më lejohet ndryshimi i kulturës nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për: Parcelën nr. 01862-1 Z.K. Dresnik, me sipërfaqe prej 2520m². Të më lejohet si tokë ndërtimore, pasi dëshiroj të ndërtoj shtëpi personale për mua dhe për familjen time të ngushtë. | **Aprovohet kerkesa** e pales për ridesitnim të parcelës në fjalë nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. |
| 62. | 06-351-13386/25<br>05.05.2025 | **Zenel Idrizi** | I/e nderuar, Jam Zenel Idrizi, nga Fshati Açarevë, me vendbanim në Dollc, me numër personal 1006414121.Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkoj nga Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të më mundësojë ndryshimin e destinimit për token, parcelën me numër 00099-9, e | **Aprovohet kerkesa** e pales për ridesitnim të parcelës në fjalë nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | cila është pronë e imja dhe e evidentuar në emrin tim personal. Parcela në fjalë momentalisht është tokë bujqësore, ndërsa kërkoj që e njëjta, në PZHK dhe në dokumentet e tjera relevante të komunës, të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të më mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. Bashkëngjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës dhe kopjen e planit të parcelës. | |
| 63. | 06-351-13280/25<br>05.05.2025 | **Fitim Berisha** | Drejtuar: Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit<br>Për përfshirjen në Planin Zhvillimor Komunal, kërkoj ndryshimin e destinimit të parcelës me nr. 02179-5, në Zonën Kadastrale Dresnik, nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Andaj, unë si pronar i kësaj parcele shpresoj që kërkesa ime do të hasë në mirëkuptim nga organi i lartpërmendur, që me rastin e miratimit të Planit Zhvillimor 2025-2033 dhe ndryshimeve të Hartës Zonale Komunale, të miratohet si e arsyeshme dhe gjithashtu të inkorporohet në këtë dokument. | **Aprovohet kerkesa** e pales për ridesitnim të parcelës në fjalë nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. |
| 64. | 06-351-13226/25<br>02.05.2025 | **Safet Gashi** | Jam Safet Gashi, nga Fshati Vajnikë, me vendbanim në Klinë - rruga "Fan Noli", me numër personal 2008370977. Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkoj nga Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të më mundësojë ndryshimin e destinimit për tokën, parcelën me numër 00587-1, e cila është pronë e imja dhe e evidentuar në emrin tim personal. Dëshiroj ta kthej në tokë ndërtimore, pasi aktualisht është tokë jo ndërtimore. Kërkoj që e njëjta, në PZHK dhe në dokumentet e tjera relevante të komunës, të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të më mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. | **Refuzohet kërkesa**, me arsyetimin se nuk është subjekt trajtimi i PZHK-së. |
| 65. | 06-351-13197/25<br>02.05.2025 | **Gllareva SH.P.K** | Duke u bazuar në planet tona afatgjata dhe me marrjen e informacionit se Komuna e Klinës është duke e hartuar Planin Zhvillimor të ri, ne, si kompani "GLLAREVA SH.P.K.", me numër unik 811281865, seli në Klinë, me pronar Bujar Morina, ndër më të mëdhajat në Komunën e Klinës dhe më tej, dëshirojmë të bëjmë disa kërkesa për ndryshim të destinimit në disa zona të caktuara në Komunën e Klinës. Kërkesa jonë është që të ndryshohet destinimi i | Kerkesa aprovohet e pjeshme<br>Aprovimi behet per parcelën që është tokë bujqesore:<br>P-00985-0 ZK Klinafc. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | pjesës së zonës industriale të Klinës. Aty për momentin një pjesë është zonë industriale, ndërsa një pjesë është zonë bujqësore.<br>Meqenëse shumica e parcelave në atë pjesë janë në pronësi të kompanisë sonë, ne planifikojmë të zgjerojmë veprimtarinë tonë. Ky zgjerim përfshin shtimin e veprimtarive që do të zhvillohen në atë zonë.<br>Ne planifikojmë: Të rrisim kapacitetin prodhues të fabrikave si dhe prodhimin e produkteve të tjera në interes të qytetarëve të Klinës, Kosovës dhe rajonit.Të investojmë në veprimtari të tjera, si objekte komerciale për reklamimin, shitjen dhe blerjen e produkteve tona.Me shtimin e numrit të punëtorëve, do të rritet kërkesa për ndërtimin e një qendre për fëmijë (çerdhe dhe shkollë), që prindërit të kenë mundësi t'i lënë fëmijët gjatë orarit të punës. Do të kërkohet ndërtimi i objekteve banimi për strehimin e punëtorëve që do të jenë në numër të madh. Ndërtimi i objekteve të ndryshme gastronomike, për të plotësuar nevojat e zonës. Meqenëse aty kalon edhe Lumi Klina, propozojmë krijimin e një zone për kultivimin e peshqve, duke ndërtuar basene për rritjen e tyre. Prandaj, ne propozojmë që ajo zonë të jetë zonë për Ndërtim të Përzier, e cila do të lejojë ndërtimin e: Fabrikave, depove, çerdheve, shkollave, objekteve të banimit, objekteve komerciale, lokaleve afariste.<br><br>Të gjitha këto veprimtari do të ndikojnë në zhvillimin e Komunës së Klinës, prandaj mendojmë se përveç interesit tonë, kjo është edhe në interes të përgjithshëm.Kërkesa jonë është që të rritet edhe etazhiteti për këtë zonë. Ne propozojmë që etazhiteti në këtë zonë të jetë B+P+6+PH. | Ndersa refuzohen te gjitha kerkesat ne lidhje me parcelat tjera me arsyeimin se nuk jane subjekt trajtimi i PZHK-se.<br><br>**Shënim:** Numrat e ketyre parcelave nuk jane shkruar tekstualisht ne kerkese, mirepo kerkesa eshte mbeshtetur me material hartografik/harte. |
| 66. | 06-351-13222/25<br><br>02.05.2025 | **Hajzer Imeri** | Jam Hajzer (Azem) Imeri, nga fshati Klinë, me vendbanim në Klinë, me numër personal 1003623661.<br>Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkoj nga Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të më mundësojë ndryshimin e destinimit për token, parcelën me numër 00137-12, e cila është pronë e imja dhe e evidentuar në emrin tim personal. Dëshiroj ta kthej në tokë ndërtimore, | **Aprovohet kerkesa** e pales për ridesitnim të parcelës në fjalë nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | pasi aktualisht është tokë bujqësore. Kërkoj që e njëjta, në PZHK dhe në dokumentet e tjera relevante të komunës, të bëhet tokë ndërtimore, me qëllim që të më mundësohet ndërtimi në këtë parcelë. | |
| 67. | 06-351-13044/25 30.04.2025 | **Driton Prenaj** **Elonida Prenaj** | Ne, Driton Prenaj dhe Eleonida Prenaj, jemi pronarë me nga ½ e parcelës me numër 00686-0, në Zonën Kadastrale Klinë, me sipërfaqe 22,556m². Si pronarë të kësaj parcele, jemi informuar se parcela e lartëcekur është në zonën e gjelbër dhe kërkojmë nga kjo Drejtori që të na mundësojë ndryshimin e destinimit, duke kaluar në zonë ndërtimore, pasi këtë parcelë e kemi blerë për investime ndërtimore.Shpresojmë që kjo kërkesë të hasë në mirëkuptim nga DUMM-Klinë.<br>Me respekt, Driton dhe Eleonida Prenaj, të cilët përfaqësohen nga Mirash Prenaj, me nr. të autorizimit LRP.Nr.6366/2022.<br>Nr. tel: 049-377-801 | **Kerkesa aprovohet pjeserisht** dhe ne ate menyre qe ne pjesen e parceles e cila nuk hynë brenda kufijëve të Zonës së Mbrojtur të Asesit lejohet ridestinimi.<br>Ndersa pjesa e parceles e cila hyn brenda kufijeve të Zonës së Mbrojtur të Asetit nuk lejohet ndërrtimi i destimit. |
| 68. | 06-351-12328/25 25.04.2025 | **Ardian Deskaj** | Nga: Arsim Desku nga Klina, me numër personal 1030613216, lëshuar nga MPB-Prishtinë, të cilin e përfaqëson me autorizim Av. Ardian Deskaj, nga Klina, rruga Preke Prendi, me numër personal 1175749493, lëshuar nga MPB-Prishtinë. Tel: 044 633 622<br>LËNDA: KËRKESË<br>Që në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, apo konkretisht në njësinë kadastrale P-71010027-01648-0, të lejohet ndërtimi me 400m² apo 500m².<br>Arsyetim:Aktualisht, në zonën kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës, në rrugën Preke Prendi, ndodhet njësia kadastrale me numër P-71010027-01648-0.Në këtë zonë, për të ndërtuar një shtëpi banimi, kërkohen 1000m² (10 ari truall) sipas rregullave të Komunës së Klinës. Zyrtarët komunalë deklarojnë se këto janë rregullat në fuqi, bazuar në Hartën Zonale të Komunës së Klinës.Së | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet brenda Zonës së Mbrojtur të Asetit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | fundmi, kemi dëgjuar se është duke u shqyrtuar ndryshimi apo revidimi i hartës zonale, apo rregullave për dhënien e lejes ndërtimore.Në këtë zonë të qytetit ka vetëm shtëpi banimi. Një shtëpi zakonisht ka sipërfaqe 10m x 10m, ose 100m² (1 ari truall).Sipas rregullit aktual, nëse shtëpia ka 100m², oborri mbetet 900m², çka nuk e dëmton tokën bujqësore, pasi nuk zë më shumë hapësirë sesa është e nevojshme. Për më tepër: Është shumë e vështirë të gjenden 10 ari për të ndërtuar një shtëpi banimi.Është e vështirë edhe që të blihen 10 ari truall për ndërtimin e një shtëpie.Me fjalë të tjera, po bëhet e pamundur që të ndërtohet shtëpi banimi. Kërkesa: Me këtë kërkesë, kërkojmë nga Komuna e Klinës, respektivisht organet përgjegjëse, që rregulli aktual të ndryshohet dhe nga 10 ari apo 1000m², leja e ndërtimit të shtëpisë të bëhet 4 ari apo 400m². Në këtë mënyrë:<br>Nëse shtëpia ka 100m², mbeten edhe 300m² oborr, që janë të mjaftueshme për nevojat e banimit.Ky model është pothuajse i njëjtë me qytetet e tjera të Kosovës dhe të shteteve të tjera.<br>Me respekt, Arsim Desku | |
| 69. | 06-351-12672/25<br>29.04.2025 | **Gjergj Marku** | Të nderuar,<br>Unë, Gjergj Marku, me banim në Videjë, si pjesë e lagjes së parë të Komunës së Klinës, ju drejtohem me këtë kërkesë, që të më mundësoni ndryshimin e destinimit të pronës sime nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, me numër 00290/4, me sipërfaqe 1300m², të gjitha këto në ZK. Videjë, për t'u përfshirë në Planin Zhvillimor 2025-2033 si tokë ndërtimi. Dokumentet e bashkangjitura kësaj kërkese janë: Fletat poseduese, kopja e planit, dokumenti i identifikimit. Me respekt, mirepresim shqyrtimin e kërkesës sonë nga Komuna e Klinës. | **Aprovohet kerkesa** me arsyetimin se parcela në fjalë gjendet në afërsi të parcelave të ndërtuara. |
| 70. | 06-351-10038/25<br>10.04.2025 | **ASNEK ENERGY SH.P.K** | LËNDA: Kërkesë për ndalimin e çdo veprimi për dhënien e lejeve të ndërtimit apo lejeve të tjera për ASNEK ENERGY SH.P.K., me seli në Miradi e Epërme, Fushë KosovëPër shkak të mospërmbushjes së detyrimeve konform ligjit ndaj kontraktuesit të parë, Ahmet Hysen Haxha, pasi i është bërë njoftimi për | **Refuzohet kërkesa**, me arsyetimin se nuk është subjekt trajtimi i PZHK-së. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ndërprerjen e kontratës, nr. ren. 3800/2023 dhe ref. nr. 1065/2023, të datës 20.06.2023.<br>Provë: Njoftimi i datës 02.04.2025. Andaj, me anë të kësaj kërkese, lusim organin kompetent, Drejtorinë për Urbanizëm në Klinë, që të mos e pajisë me asnjë leje ndërtimi apo leje tjetër, deri në përmbushjen e obligimeve nga kontraktuesi i dytë, ASNEK ENERGY SH.P.K., me seli në Miradi të Epërme, Fushë Kosovë, ndaj kontraktorit të parë, Ahmet Haxha.Në rast se arrihet ndonjë marrëveshje ndërkohë mes kontraktuesve, atëherë ushtruesi i kërkesës, Ahmet Haxha, do ta tërheqë këtë kërkesë. Klinë, më 08.04.2025. | |
| 71. | 06-351-12750/25<br>29.04.2025 | **Rrahim Qerkinaj** | Jam Rrahim (Ramë) Qerkinaj, nga Prishtina, me numër personal 1172894859. Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkoj nga Komuna e Klinës, respektivisht Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, që të më mundësojë ndryshimin e destinimit për tokën, parcelat me numër 00082-0, 00081-1, 00081-2, 00081-3, të cilat janë pronë e imja dhe të evidentuara në emrin tim personal. Parcelat në fjalë momentalisht janë tokë bujqësore, ndërsa kërkoj që të njëjtat, në PZHK dhe në dokumentet e tjera relevante të komunës, të bëhen tokë ndërtimore, me qëllim që të më mundësohet ndërtimi në këto parcela. Bashkangjitur gjeni certifikatën e pronësisë së tokës. | **Aprovohet kërkesa e palës** për ndërrim të destinimit të parcelavë në fjalë. |
| 72. | 06-352-12570/25<br>28.04.2025 | **Solariss L.L.C** | Drejtohem në cilësinë e drejtorit menaxhues të ndërmarrjes Solariss L.L.C., me numrin unik identifikues 812014512, me seli në Rruga Pashko Vasa, Kati VIII, Nr.6, 10000 Prishtinë, Kosovë. Qëllimi kryesor i ndërmarrjes Solariss L.L.C. është zhvillimi, financimi, ndërtimi dhe operimi i impianteve fotovoltaike (parqe solare), përfshirë Parkun Solar në Z.K. Berkovë, Komuna e Klinës. Për tokën ku planifikohet të ndërtohet parku solar, ndërmarrja Solariss L.L.C. posedon kontratën për qiramarrje të tokës, me kohëzgjatje 40 vjet. Dokumentet e bashkangjitura kësaj kërkese janë: Kopja e kontratës për qiramarrje, kopja e planit, kopja e certifikatave të pronës, koordinatat e vendndodhjes së Parkut Solar Berkovë. Ngastra ku planifikohet të ndërtohet | Aprovohet kërkesa e palës, me arsyetimin se parcela në fjalë i takon kategorisë V të bonitetit të tokës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | parku solar dhe infrastruktura përcjellëse ndodhet në Zonën Kadastrale Berkovë, me numër të ngastrës P-71006004-00416-4 (Arë e Klasës 5).Projekti i propozuar është në harmoni me parimet e Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, e cila parasheh ndërtimin e rreth 1,600 MË të kapaciteteve të reja gjeneruese, bazuar në burimet e ripërtëritshme, përfshirë energjinë solare.Ndërtimi i këtij parku solar do të jetë mjaft domethënës për komunitetin dhe fshatrat përreth, përmes krijimit të vendeve të reja të punës (direkte dhe indirekte), Komunën e Klinës, si dhe për Kosovën në përgjithësi. Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë nga K.K. Klinë përfshirjen e Z.K. Berkovë në listën e zonave kadastrale ku parashihet shfrytëzimi i përkohshëm për energji të ripërtëritshme (faqe 232, draft dokumenti Plani Zhvillimor Komunal 2025 - 2032, nënkapitulli 4.3.3.3 Energjia elektrike dhe termike).Gjithashtu, kërkojmë përfshirjen e Z.K. Berkovë në listën e zonave kadastrale me bonitet të tokës – Klasa e Pestë (faqe 74, draft dokumenti Plani Zhvillimor Komunal 2025 - 2032). Jemi në dispozicion të plotë për të ofruar çfarëdo informacioni shtesë që mund të kërkohet. | |
| 73. | 06-351-12515/25<br>28.04.2025 | **Prend Heqimi** | Unë, Prend Heqimi, jam pronar faktik dhe juridik i Njësive Kadastrale Nr. 00421-1 Z.K. Zllakuqan, në vendin e quajtur Fshati, me sipërfaqe 6690m², me kulturë kullotë e klasës 2, dhe Nr. 00421-4 Z.K. Zllakuqan, në vendin e quajtur Fshati, me sipërfaqe 4090m², me kulturë bujqësore – livadh i klasës 4. Me anë të kësaj kërkese, kërkoj që të më lejohet ndërrimi i kulturës për:<br><br>Njësinë kadastrale Nr. 00421-1 Z.K. Zllakuqan, me sipërfaqe 6690m², Njësinë kadastrale Nr. 00421-4 Z.K. Zllakuqan, me sipërfaqe 4090m². Nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për shkak se i kemi të ndërtuara shtëpitë prej dekadash dhe jetojmë në këtë parcelë. Këtë kërkesë për ndërrimin e kulturës e bëjmë për legalizimin e shtëpive ekzistuese dhe pajisjen me leje ndërtimi për shtëpitë e reja që planifikojmë të ndërtojmë, sepse si familje jemi zgjeruar dhe | **Aprovohet pjesërisht kërkesa** dhe në atë mënyrë që pjesët e parcelavë që mbesin jashtë Brezit Ujor do të destinohet për tokë ndërtimore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | nuk kemi truall diku tjetër për ndërtim. Për mirëkuptimin dhe lejimin e ndërrimit të kulturës, ju jemi mirënjohës. | |
| 74. | 06-351-12513/25<br>28.04.2025 | **Zef Heqimi** | Nga: Zef Nikoll Heqimi, nga Fshati Zllakuqan, Komuna e Klinës. Unë, Zef Heqimi, jam pronar faktik dhe juridik i Njësisë Kadastrale Nr. 00421-2 Z.K. Zllakuqan, në vendin e quajtur Fshati, me sipërfaqe 10,429m², me kulturë bujqësore – arë e klasës 2. Me anë të kësaj kërkese, kërkoj që të më lejohet ndërrimi i kulturës për Njësinë Kadastrale Nr. 00421-2 Z.K. Zllakuqan, me sipërfaqe 10,429m², nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për shkak se i kemi të ndërtuara shtëpitë me dekada dhe jetojmë në këtë parcelë. Këtë kërkesë për ndërrimin e kulturës e bëjmë për legalizimin e shtëpive ekzistuese dhe pajisjen me leje ndërtimi për shtëpitë e reja, që planifikojmë të ndërtojmë, sepse si familje jemi zgjeruar dhe nuk kemi truall diku tjetër për ndërtim. Për mirëkuptimin dhe lejimin e ndërrimit të kulturës, ju jemi mirënjohës. | **Aprovohet pjesërisht kërkesa** dhe në atë mënyrë që pjesët e parcelavë që mbesin jashtë Brezit Ujor do të destinohet për tokë ndërtimore. |
| 75. | 06-351-12520/25<br>28.04.2025 | **Pjeter Heqimi** | Nga: Pjetër Kolë Heqimi, nga Fshati Zllakuqan, Komuna e Klinës.<br>Unë, Pjetër Heqimi, jam pronar faktik dhe juridik i Njësisë Kadastrale Nr. 00421-3 Z.K. Zllakuqan, në vendin e quajtur Fshati, me sipërfaqe 7,650m², me kulturë bujqësore – arë e klasës 4.<br>Me anë të kësaj kërkese, kërkoj që të më lejohet ndërrimi i kulturës për Njësinë Kadastrale Nr. 00421-3 Z.K. Zllakuqan, me sipërfaqe 7,650m², nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për shkak se i kemi të ndërtuara shtëpitë me dekada dhe jetojmë në këtë parcelë. Këtë kërkesë për ndërrimin e kulturës e bëjmë për legalizimin e shtëpive ekzistuese dhe pajisjen me leje ndërtimi për shtëpitë e reja, që planifikojmë të ndërtojmë, sepse si familje jemi zgjeruar dhe nuk kemi truall diku tjetër për ndërtim.<br>Për mirëkuptimin dhe lejimin e ndërrimit të kulturës, ju jemi mirënjohës. | **Aprovohet pjesërisht kërkesa** dhe në atë mënyrë që pjesët e parcelavë që mbesin jashtë Brezit Ujor do të destinohet për tokë ndërtimore. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 76. | 06-463-15159/25<br>21.05.2025 | **Arif Krasniqi** | Jam Arif Krasniqi, dhe kërkoj nga DUMM që parcela me numër 00137-3, e cila ndodhet në zonë bujqësore, të kthehet në tokë ndërtimore, në Zonën Kadastrale Dresnik. | **Aprovohet kerkesa e pales** me arsyetimin se përreth parcelës në fjalë ka ndërtim |
| 77. | 06-463-15165/25<br>21.05.2025 | **Nebi Dushi** | Nga: Nebi Dushi, Klinë 06 463-15165/25<br>LËNDA: Kërkesë për futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor të parcelave Nr. P-71010027-00253-4, P-71010027-253-5, P-71010027-00265-1, P-71010027-02162-27 dhe P-71010027-00253-2, në Zonën Kadastrale Dresnik.<br>Kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për futjen në zonën ndërtimore me plan zhvillimor të parcelave me Nr. P-71010027-00253-4, P-71010027-253-5, P-71010027-00265-1, P-71010027-02162-27 dhe P-71010027-253-2, në Zonën Kadastrale Dresnik, pasi ato janë të ndara në parcela dhe ndodhen në një zonë ku ka ndërtime në të dyja anët. Në këtë pjesë, lagjet përreth janë të ndërtuara me shtëpi banimi, por vetëm parcela për të cilën kërkoj leje ndërtimi ka mbetur jashtë kësaj rregulloreje, ndonëse ndërtimi në këtë zonë ka filluar që nga vitet e hershme dhe vazhdon ende.<br>Në këtë zonë, shtëpitë e ndërtuara më herët janë në proces legalizimi, dhe për këtë arsye, kërkojmë që kërkesa jonë të shqyrtohet me mirëkuptim nga Drejtoria e Urbanizmit, që me rastin e aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkesa jonë të aprovohet si e arsyeshme dhe të inkorporohet në Hartën Zonale, duke mundësuar ndërtimin në këtë zonë. Me respekt, Parashtruesi i kërkesës. | Aprovohet kërkesa me arsyetimin se sipas draftit aktual të PZHK 2025-2033, parcelat në fjalë gjendet brenda kufirit ndërtimor të ZK Dresnik. |
| 78. | 06-463-15176/25<br>21.05.2025 | **Egzon Bytyqi** | Unë, Egzon Bytyqi, me numër personal 1174037236, nëpërmjet kësaj kërkese i drejtohem Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për dy parcela në pronësinë time, në Zonën Kadastrale Dollc:<br>P-71010022-00083-0, me sipërfaqe 625m²; P-71010022-00077-3, me sipërfaqe 2002m². Në total, 2627m².<br>Nëpërmjet Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj ndryshimin e destinimit | **Kërkesa aprovohet** me arsyetimin se kjo parcelë ndodhet ne trasenë e rruges se palnifikuar sipas HZK-së (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | të këtyre parcelave nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore P+3.<br>Arsyeshmëria: Duke qenë se toka përreth, në afërsinë maksimale prej 200m, është tokë ndërtimore, dhe për shkak të planifikimit të zgjerimit të qytetit, kërkoj që të bëhet ndryshimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore P+3.<br>Kërkesa: Kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që kërkesa jonë të miratohet përmes PZHK, në mënyrë që të na mundësohet ri-destinimi i parcelave. | |
| 79. | 06-463-15220/25<br>22.05.2025 | **Luigj Malota** | Unë, Luigj Malota, me numër personal 1233693207, nëpërmjet kësaj kërkese i drejtohem Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për një parcelë në pronësinë time, në Zonën Kadastrale Dollcë, me numër P-71010022-00077-1, me sipërfaqe 3568m².<br>Nëpërmjet Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj ndryshimin e destinimit të kësaj parcele nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore P+3K.<br>Arsyeshmëria:Duke qenë se toka përreth, në afërsinë maksimale prej 200m, është tokë ndërtimore, dhe për shkak të planifikimit të zgjerimit të qytetit, kërkoj që të bëhet ndryshimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore P+3K.<br>Kërkesa:Kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që kërkesa ime të miratohet përmes PZHK, në mënyrë që të mundësohet ri-destinimi i parcelës. | **Kërkesa aprovohet pjesërisht** dhe në atë mënyrë që aprovohet kërkesa për ndryshim të destinimit të parcelës me nr. 00077-1 nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, ndërsa **refuzohet kërkesa lidhur me etazhitetin e parcelës** me arsyetimin se nuk është subjekt i trajtimit të PZHK-së. |
| 80. | 06-463-15189/25<br>22.05.2025 | **Imer Elezaj** | Unë, Imer Elezaj, duke u bazuar në planet e mia afatgjata dhe me marrjen e informacionit se Komuna e Klinës është duke hartuar Planin Zhvillimor të ri, bëj kërkesë për ndryshimin e destinimit të parcelës që është në pronësinë time.Parcela në fjalë për momentin është e destinuar si tokë bujqësore. Megjithatë, duke u bazuar në zhvillimin e tanishëm të kësaj zone, kërkesa është e madhe për ta bërë tokë ndërtimore.Pozita e saj është shumë e mirë për banim, pasi ndodhet afër qytetit dhe rrugëve kryesore rajonale. Pjesa më e madhe e | **Aprovohet kërkesa** me arsyetimin se parcela gjendet brenda kufirit ndërtimot të ZK Dresnik, ndërsa etazhiteti nuk është |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | parcelave përreth janë të ndërtuara me shtëpi banimi.Prandaj, duke u bazuar në këto të dhëna, bëj kërkesë që kjo zonë të bëhet zonë ndërtimi për banim, me etazhitet deri në B+P+4+Ph.<br>Parcela në fjalë është 02323-0, në Zonën Kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës. | subjket i trajtimit të PZHK-së. |
| 81. | 06-463-15248/25<br>22.05.2025 | **Arianit Nrecaj** | Për: Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit – Klinë<br>Kërkoj nga drejtoria në fjalë për plotësimin dhe ndryshimin e destinimit të parcelës Nr. 00550-3, në Z.K. Dresnik, me sipërfaqe 550m², duke kaluar nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.<br>Arsyeshmëria: Kërkesa bazohet konform Planit Zhvillimor Komunal (PZHK). | **Aprovohet kerkesa** e pales me arsyetimin se ne parcelat per rreth saj veq jane parcela te ndertuar me shpi banimi.<br>Sqarim: parcela eshte e klasit te VI të bonitetit të tokës |
| 82. | 06-463-15275/25<br>22.05.2025 | **Baki Morina – Mevlide Morina** | LËNDA: Kërkesë për shqyrtimin dhe ndryshimin e destinimit të disa parcelave në Zonën Kadastrale Zajm, gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të ri të Komunës së Klinës.<br>Të nderuar,<br>Me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Klinës, dëshiroj të paraqes këtë kërkesë pranë Drejtorisë së Urbanizmit, që të merret parasysh propozimi im për ndryshimin e destinimit të zonës ku gjenden parcelat e mia me numër: 00857-8; 00857-7; 00857-6, në Zonën Kadastrale Dresnik.<br>Këto parcela ndodhen përgjatë rrugës magjistrale Prishtinë-Pejë, me qasje të drejtpërdrejtë prej rreth 360 metrash në këtë aks rrugor, çka e bën këtë zonë jashtëzakonisht të favorshme për zhvillim ekonomik. Pozicioni strategjik përgjatë rrugës kryesore, si dhe largësia e konsiderueshme nga zonat e banuara, krijojnë kushte optimale për investime të karakterit industrial dhe afarist, si nga investitorë të huaj, ashtu edhe të brendshëm. Nëse ofrohet infrastruktura e nevojshme (rrugë, energji, ujë, kanalizim, etj.), kjo zonë mund të kthehet në një pikë tërheqëse për kompani të mëdha ndërkombëtare apo vendore, të cilat mund | **Refuzohet kerkesa** për ndërrim të destinimit të parcelave në fjalë, me arsyetimin se parcelat gjenden ne zone pyjore (Mal i Klasës 4). Vendimi për refuzim bazohet në **Ligjin Nr. 02/L-26 Për Tokën Bujqësore**. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | të vendosin aty objekte prodhimi, zyra, qendra logjistike apo biznese të tjera, që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik të komunës sonë dhe të Republikës së Kosovës në përgjithësi. Me respekt. | |
| 83. | 06-463-15276/25<br>22.05.2025 | **Nazmi Morina** | Parcela kadastrale nr. 01345-2 – ZK Dresnik, Komuna e Klinës<br>I nderuar staf i Drejtorisë së Urbanizmit, Nr: 06-463-15276/115 Me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, ju drejtohem me këtë kërkesë, që të shqyrtohet mundësia për ndryshimin e destinimit të parcelës me numër kadastral 01345-2, e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës. Kjo parcelë ka një pozicion shumë të favorshëm për zhvillim ndërtimor, pasi ndodhet në afërsi të tranzitit të ri të Klinës, duke e bërë atë strategjikisht të përshtatshme për zhvillim urban. Meqenëse kjo zonë është në zgjerim të vazhdueshëm dhe pritet të shndërrohet në një nyje të rëndësishme ekonomike dhe funksionale për komunën, propozohet që parcela në fjalë të kategorizohet si tokë ndërtimore për objekte me shfrytëzim të përzier.<br>Arsyetimi i propozimit: Aksesi i drejtpërdrejtë dhe afërsia me tranzitin e ri; Pozicion i volitshëm për zhvillim të infrastrukturës banesore, afariste dhe shërbyese; Potencial i lartë për tërheqjen e investimeve në ndërtim dhe zhvillim të qëndrueshëm urban.<br>Etazhiteti i propozuar: B+P+6 kate + penthouse (PH) – për të mundësuar ndërtimin e objekteve multifunksionale me përdorim të përzier, përfshirë banim, afarizëm dhe shërbime të ndryshme publike e private.Ky ndryshim do të ndihmonte jo vetëm në rritjen e vlerës së tokës dhe zhvillimin ekonomik lokal, por edhe në përmbushjen e kërkesave të rritura për hapësira urbane cilësore në zonat përreth tranzitit të ri. | Parcela ne fjale sipas HZK 2020-28 eshte toke ndertimore dhe si e tille ndodhet ne ZSHP2, mirpo vlene te theksohet se ne mes te parceles kalon traseja e tranzitit te planifikuar gje e cila duhet te hiqe sepse tash me veq se ekziston projekti ne zbatim dhe nuk kalon neper kete trase. |
| 84. | 06-463-15417/25<br>23.05.2025 | **Fidaim Hoti** | Unë, Fidaim Hoti, me numër personal 1009620822, nëpërmjet kësaj kërkese i drejtohem Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për parcelën në pronësinë time, në Zonën Kadastrale Dollc, me numër P-71010022-00080-1, me sipërfaqe 3379m².Nëpërmjet Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj | **Kërkesa aprovohet** me arsyetimin se zona perrreth është e ndertuar si dhe |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | ndryshimin e destinimit të kësaj parcele nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.Kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që kërkesa jonë të miratohet përmes PZHK, në mënyrë që të mundësohet ri-destinimi i parcelës. | parcela gjendet pergjate trasesë se tranzitit. |
| 85. | 06-463-15414/25<br>23.05.2025 | **Bujar Dakaj** | Unë, Bujar Electronics Center SH.P.K., me pronarë Bujar Dakaj dhe Zoje Dakaj, nëpërmjet kësaj kërkese i drejtohem Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për dy parcela në pronësinë time, në Zonën Kadastrale Dresnik, me numër P-71010027-02362-0.<br>Nëpërmjet Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj ndryshimin e etazhitetit në P+7.<br>Arsyeshmëria: Duke qenë se toka përreth, në afërsinë maksimale prej 200m, është tokë ndërtimore, dhe për shkak të planifikimit të zgjerimit të qytetit, kërkojmë rritjen e etazhitetit.<br>Kërkesa: Kërkojmë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që kërkesa jonë të miratohet përmes PZHK, në mënyrë që të mundësohet ndërtimi i objektit me këtë etazhitet. | **Kërkesa refuzohet** me arsyetimin se nuk është subjekt i trajtimit të PZHK-së. |
| 86. | 06-463-15426/25<br>23.05.2025 | **Artan Berisha, Sabahat Rudaj Berisha** | Unë, Artan Berisha, me numër letërnjoftimi 1007310931, nga Denjë, KK Rahovec, dhe Sabahat Rudaj Berisha, me numër letërnjoftimi 1018148095, nga Denjë, KK Rahovec, kërkojmë që të bëhet ndryshimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për parcelën tonë me numër P-71010027-00146-4, në Zonën Kadastrale Dresnik, KK Klinë. Arsyeja e kërkesës është se po planifikojmë të ndërtojmë një shtëpi banimi. | **Aprovohet kerkesa** e palës me arsyetimin se parcelat gjenden brenda kufirit ndërtimor të ZK Dresnik |
| 87. | 06-463-15428/25<br>23.05.2025 | **Feim Zenunaj** | Unë, Feim Zenunaj, me numër letërnjoftimi 1003457750, nga Gremniku, KK Klinë, kërkoj që të bëhet ndryshimi i destinimit nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore, për parcelat që kam në posedim, me numër P-71010017-01269-1 dhe P-71010017-01269-2, në Zonën Kadastrale Gremnik, KK Klinë. Arsyeja e kërkesës është se po planifikoj të ndërtoj një shtëpi banimi. | **Aprovohet kerkesa** e palës me arsyetimin se parcelat gjenden brenda kufirit ndërtimor të ZK Gremnik. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 88. | 06-463-15421/25<br>23.05.2025 | **Abedin Hoti** | Unë, Abedin Hoti, me numër personal 1174651295, nëpërmjet kësaj kërkese i drejtohem Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për parcelën në pronësinë time, në Zonën Kadastrale Dollc, me numër P-71010022-00084-1, me sipërfaqe 1000m². Nëpërmjet Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj ndryshimin e destinimit të kësaj parcele nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që kërkesa ime të miratohet përmes PZHK, në mënyrë që të mundësohet ri-destinimi i parcelës. | **Aprovohet kërkesa e palës** me arsyetimin se zona per rreth veq eshte e ndertuar dhe parcela eshte pergjate trases se tranzitit |
| 89. | 06-463-15437/25<br>23.05.2025 | **Mirusha Company SH.P.K** | Nga: Mirusha Company Sh.P.K. Nr: 06-463-15437/217 Drejtuar: Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.<br>LËNDA: Kërkesë për shqyrtimin dhe ndryshimin e destinimit të parcelave nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.<br>I nderuar Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit,<br>Mirusha Company Sh.P.K., me pronarë Fidan Selimi, Mentor Selimi dhe Selman Selimi, banorë të Komunës së Klinës, nëpërmjet kësaj shkrese, ju drejtohemi me kërkesën për shqyrtimin e mundësisë së ndryshimit të destinimit të disa parcelave kadastrale në Dresnik, të cilat aktualisht, sipas Hartës Zonale, figurojnë si tokë bujqësore, me qëllim të shndërrimit të tyre në tokë ndërtimore.<br>Parcelat për të cilat kërkojmë shqyrtimin janë si më poshtë, në Zonën Kadastrale Dresnik: Parcela nr. 01515-0; Parcela nr. 01522-0; Parcela nr. 01523-0; Parcela nr. 01524-0; Parcela nr. 01525-0;<br>Parcela nr. 01531-0; Parcela nr. 01532-0; Parcela nr. 01533-0; Parcela nr. 01534-0; Parcela nr. 01535-0.<br>Duke marrë parasysh nevojat për zhvillim dhe potencialin për ndërtim të këtyre zonave, kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit që të shqyrtojë këtë kërkesë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dokumentet planifikuese të komunës, për të vlerësuar mundësinë e ndryshimit të destinimit në përputhje me Planin Rregullues dhe prioritetet zhvillimore të Komunës së Klinës. | **Refuzohet kërkesa** me arsyetimin se parcelat në fjalë i takojnë Kategorisë III të Bonitetit të Tokës.<br>Miratimi i kësaj kërkese do të sillte rrezikun e një shpërndarjeje sporadike dhe të paqëndrueshme të zhvillimit urban, duke cenuar kohezionin dhe qëndrueshmërinë hapësinore të zonës së ndërtuar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 90. | 06-463-15438/25<br><br>23.05.2025 | **Mirusha Company SH.P.K** | Nga: Mirusha Company Sh.P.K. Nr: 463-15138/25 Drejtuar: Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit LËNDA: Kërkesë për shqyrtimin dhe ndryshimin e destinimit të parcelave nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore.<br>I nderuar Drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit,<br>Mirusha Company Sh.P.K., me pronarë Fidan Selimi, Mentor Selimi dhe Selman Selimi, banorë të Komunës së Klinës, nëpërmjet kësaj shkrese ju drejtohemi me kërkesën për shqyrtimin e mundësisë së ndryshimit të destinimit të disa parcelave kadastrale në Dollc, të cilat aktualisht, sipas Hartës Zonale, figurojnë si tokë bujqësore, me qëllim të shndërrimit të tyre në tokë ndërtimore.Parcelat për të cilat kërkojmë shqyrtimin janë si më poshtë, në Zonën Kadastrale Dollc: Parcela nr. 00005-0; Parcela nr. 00006-0; Parcela nr. 00100-1; Parcela nr. 0080-3; Parcela nr. 02244-0.<br>Duke marrë parasysh nevojat për zhvillim dhe potencialin për ndërtim të këtyre zonave, kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit që të shqyrtojë këtë kërkesë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dokumentet planifikuese të komunës, për të vlerësuar mundësinë e ndryshimit të destinimit në përputhje me Planin Rregullues dhe prioritetet zhvillimore të Komunës së Klinës. | **Kërkesa aprovohet,** me arsyetimin se parcelat me nr:00005-0 :00006-6, sipas HZK-së janë tokë ndërtimore (ZSHP3) dhe si të tilla nuk janë subjekt i trajtimit të PZHk-së.<br><br>Sa i përket parcelës me nr. 00100-1, në gjysmën e kësaj parcele kalon trasea e rruges se palnifikuar sipas HZK-së (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. Edhe kjo kërkesë aprovohet.<br><br>Parcela me nr. 0080-3 gjendet komplet në trasenë e rrugës së palnifikuar sipas HZK-së (Kijev- Zahaq) traseja e së cilës është ndryshuar. Edhe kjo kërkesë aprovohet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Aprovohet kërkesa për destinim të parcelës me nr. 02244-0 ZK Dresnik nga Toka Bujqësore në Tokë Ndërtimore. |
| 91. | 06-350-15445/25<br>23.05.2025 | **Blerim Elezaj** | KËRKESË<br>Data: 23.05.2025 Nr: 06-350-15445/25. Drejtuar: Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Komuna e Klinës.<br>LËNDA: Kërkesë për rritjen e koeficientit të ndërtimit dhe etazhitetit<br>Unë, Blerim Elezaj, si pronar i parcelave me numra 00230-20, 00231-29 dhe 00226-1, që ndodhen në Zonën Kadastrale Klinë, me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Klinës, paraqes këtë kërkesë për shqyrtim dhe miratim të ndryshimeve të kushteve ndërtimore për parcelat në fjalë. Duke marrë parasysh që: Parcelat ndodhen në një lokacion të favorshëm, shumë afër qendrës së qytetit të Klinës; Kërkesa për njësi të reja banesore dhe afariste në këtë zonë është në rritje të vazhdueshme;<br>Infrastruktura ekzistuese është e përshtatshme për zhvillime më intensive ndërtimore. Kërkoj që të shqyrtohet dhe miratohet rritja e koeficientit të ndërtimit dhe etazhitetit për parcelat e lartpërmendura, në përputhje me nevojat urbane dhe planifikimin e Komunës së Klinës. Me respekt, Blerim Elezaj. | **Refuzohet kërkesa** me arsyetimin se nuk është subjekt i trajtimit të PZHK-së. |
| 92. | 06-463-15439/25<br>23.05.2025 | **Egzon Bytyqi** | Unë, Egzon Bytyqi, me numër personal 1174037236, nëpërmjet kësaj kërkese i drejtohem Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për parcelën në pronësinë time, në Zonën Kadastrale Dresnik, me numër P-71010027-02363-0, me sipërfaqe 3100m².Nëpërmjet Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), kërkoj ndryshimin e destinimit të kësaj parcele nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. | **Aprovohet kërkesa** me arsyetimin se zona per rreth veq eshte e ndertuar dhe parcela eshte afer trases se tranzitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Kërkoj nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që kërkesa ime të miratohet përmes PZHK, në mënyrë që të mundësohet ri-destinimi i parcelës. | |
| 93. | 06-463-15441/25<br>23.05.2025 | **Xhevat Pantina** | KËRKESË PËR NDRYSHIM DESTINIMI TË PARCELAVE NË TOKË NDËRTIMORE Data: 23.05.2025 Nr: 06-463-15441/25.<br>Drejtuar: Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Komuna e Klinës Të nderuar staf i Drejtorisë,<br>Me rastin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Klinës, unë, Xhevat Pantina, me numër personal 2003721127, me vendbanim në Gllarevë, Klinë, paraqes këtë kërkesë për ndryshim të destinimit të parcelave në pronësinë time, të cilat ndodhen në Zonën Kadastrale Dresnik, Komuna e Klinës. Parcelat në fjalë janë si vijon: 00351-0;<br>00366-0; 00367-0; 00487-0; 00490-1; 00490-2; 00506-0; 00511-0; 00513-0; 00507-0; 00508-0; 00509-0; 00510-0.<br>Arsyetimi i propozimit për ndryshim destinimi. Pozita gjeografike e këtyre parcelave është tejet e favorshme për zhvillim ndërtimor, pasi shumica prej tyre shtrihen përgjatë rrugës së re të tranzitit të Klinës, duke ofruar një qasje të drejtpërdrejtë dhe infrastrukturë strategjike. Kjo zonë përbën potencial të lartë për zhvillim urban dhe ekonomik.Lokacioni përgjatë aksit të tranzitit të ri i jep vlerë të shtuar investimeve.Zona është në fazë zgjerimi urban dhe ka nevojë për planifikim të qëndrueshëm ndërtimor.Shfrytëzimi i tokës për ndërtim do të kontribuonte në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.Duke marrë parasysh potencialin dhe nevojat zhvillimore, kërkoj që parcelat e lartpërmendura të kategorizohen si tokë ndërtimore, duke lejuar shfrytëzimin e tyre për zhvillim urban dhe investime.<br>Me respekt, Xhevat Pantina. | **Kerkesa aprovohet pjesërisht.**<br>**Parcelet qe aprovohen** per ridestinim nga toka bujqesore -pyjore ne ate ndertimore jane:<br>00487-0<br>00490-1<br>00490-2<br>00506-0<br>00511-0<br>00507-0<br>00508-0<br>00509-0 zk. Dresnik<br><br>Ndërsa **refuzohet kërkesa për ri-destinim** të parcelavenë vijim:<br>00351-0<br>00367-0<br>00511-0 zk, dersnik Komuna Klinë. |
| 94. | 06-463-15444/25 | **Petrit Berisha** | Meqenëse është duke u projektuar Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Klinës dhe ekziston mundësia për ndryshime në destinimet e shfrytëzimit të parcelave brenda territorit të komunës, unë, Petrit Berisha, bëj kërkesë që të merret parasysh propozimi | **Refuzohet kërkesa,** me arsyetimin se parcela në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 23.05.2025 | | im për parcelën që është në pronësinë time.Parcela me Nr. 02222-0, në Zonën Kadastrale Dresnik, është e vendosur përgjatë tranzitit të planifikuar për ndërtim në zonën e Dresnikut. Me ndërtimin e kësaj rruge, shumica e veturave me drejtim Skenderaj-Istog do të kalojnë në këtë pjesë, çka pritet të sjellë rritje të kërkesës për investime në këtë zonë, përgjatë kësaj rruge.<br>Prandaj, kërkoj që kjo zonë të kategorizohet si zonë ndërtimi dhe të rritet etazhiteti i ndërtimit deri në B+P+6+Ph. | fjalë gjendet brenda Zonës së Mbrojtur të Asetit. |
| Kërkesat e propozuara nga Komuna | | | | |
| 1 | **Komuna Klinë**<br>22.05.2025 | | Parcela me nr. 01369-45 ZK Siqeve Komuna Klinë te ridestinohet nga zona bujqësore ne zonë per shfrytësim dytësor te perkohshem per energji solare si zone me potencian te favorshem energjetik me arsyetim se klasa e tokes eshte mbi klasen e 4. | **Aprovohet kërkesa e komunës** me arsyetimin se parcela është mbi kategorine IV të bonitetit të tokës. |
| 2 | **Komuna Klinë**<br>22.05.2025 | | Propozohet që parcelat me nr. P- 71010028-00011-0; P- 71010028-00012-0; P- 71010028-00003; P- 71010028-00007 dhe P- 71010028-00001 ZK Dush si dhe parelat me nr. P- 71010010-00441-0; P- 71010010-00443-0 dhe P- 71010010-00470-0 ZK Volljakë te ridestinohen si zona per shfrytësim dytësor te perkohshem per energji solare si zone me potencil energjetik me arsyetim se klasa e tokes eshte mbi klasen e 4 dhe po ashtu eshte komplet zone e pa shfrytezuar qe nuk kultivon asnje lloj bime (zone shkurre dhe shkembore). | **Aprovohet kërkesa e komunës** me arsyetimin se kjo zonë ka potencial për zhvillimin e kësaj veprimtarie sepse parcela gjendet në zonë vullkanike dhe nuk mund të zhvillohet bujqësia dhe/apo pylltaria. |
| 3 | **Komuna Klinë**<br>22.05.2025 | | Komuna e Klinës kërkon nga ministritë e linjës që trasenë e vjetër të autostradës së planifikuar Kijevë-Zahaq e cila tashmë është zhvendosur dhe njëkohësisht është duke u ekzekutuar përgjatë rrugës ekzistuese (si zgjerim), të hiqet nga hartat dhe dokumentet tjera të planifikimit dhe të lirohen të gjitha pronat të cilat kanë qenë subjket i shpronësimit për nevoja të autostradës. Kjo për shkak se shumica e palevë janë ankuar për pa-mundësinë e paisjes me leje ndërtimore për shkak të këtij problemi. Ndërsa ka pasur disa raste në të cilat Zyra Ligjore e MMPHI-së u ka dhënë të drejtë paleve pasiqë paraprakisht janë | **Aprovohet kërkesa e komunës** me arsyetimin se kjo trase vetëmse është jashtë ndërtimit ngase tani për tani është zhvendosur në trasenë ekzistuse-zgjerim i rrugës aktuale dhe janë duke u zhvilluar punimet. Kjo situatë e përjashton trasenë e planifikuar |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | refuzuar nga komuna. Lëndët e tilla janë aprovuar si kërkesa të bazuara të palëve. | në dokumentet planifikuese të më hershme. Po ashtu, kjo trase nuk figuron as në Ortofoton e vitit 2024 në Gjeoportalin e Kosovës. |

Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Kërkesave, Vërejtjeve dhe Sugjerimeve për Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033.

1.Klementina Qerkinaj– Kryesues i Komisionit

2.Xhezide Trepça Gashi – Anëtare

3. Adem Sejdiu – Anëtare

4.Altin Mujaj – Anëtar

5.Antonije Selmani – Anëtar